

# Zhvillimet dhe ndryshimet ligjore të të drejtave në punë dhe dialogut social

2019-2020

**Punoi Raportin: Zyhrada Kongoli**

**Copyright:** Qendra për të Drejtat në Punë, CLR

**Phone**

+355 69 402 0057

**Address**

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

**Website**

[www.clr.al](http://www.clr.al)

## PËRMBAJTJA

1.	<b>Tregu i punës, 2019-2020</b>	Faqe.....5
2.	<b>Situata pandemike Covid 19 dhe reagimi i tregut</b>	Faqe.....5
3.	<b>Ndikimi nga pandemia dhe masat që u ndërmorën nga qeveria</b>	Faqe.....6
4.	<b>Ndryshimet ligjore dhe reagimi nëpërmjet akteve nga qeveria</b>	Faqe.....7
4.1.	Ndryshimet ligjore dhe nënligjore, 2019	Faqe.....7
4.2.	Ndryshimet ligjore dhe nënligjore, 2020	Faqe.....9
5.	<b>Aktivitetet kryesore sindikaliste dhe të shoqërisë civile gjatë 2019 dhe 2020</b>	Faqe.....11
5.1.	Aktivitetet dhe jeta sindikaliste, 2019	Faqe.....11
5.2.	Aktivitetet dhe jeta sindikaliste, 2020	Faqe.....15
5.2.1.	<i>Aktivitete informuese, mediatike dhe edukuese</i>	Faqe.....15
5.2.2.	<i>Marëdhëniet me partnerët dhe institucionet</i>	Faqe.....17
5.2.3.	<i>Siguria dhe Shëndeti në Punë</i>	Faqe.....19
5.2.4.	<i>Mbrojtja e të drejtave në punë</i>	Faqe.....20
5.2.5.	<i>Forcimi i dialogut social dhe kontrata kolektive</i>	Faqe.....24
5.2.6.	<i>Jeta sindikaliste dhe marëdhëniet publike</i>	Faqe.....30
5.2.7	<i>Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave dhe vajzave në botën e punës</i>	Faqe.....33
5.2.8	<i>Situata pandemike e Covid 19 dhe reagimet e CLR dhe organizatave partnere</i>	Faqe.....34
<i>Kuti 1</i>	<i>Histori suksesi të sindikatave të reja</i>	Faqe.....49

## SHKURTIME DHE SQARIME TERMASH

AFL-CIO	AMERICA'S UNIONS
BE	BASHKIMI EVROPIAN
BIRN	RRJETI I GAZETARISË INVESTIGATIVE BALLKANIKE
BSPSH	BASHKIMI SINDIKATAVE TË PAVARURA SHQIPTARE
CLR	QENDRA PËR TË DREJTAT NË PUNË
CDCI	QENDRA PËR ZHVILLIM, BASHKËPUNIM DHE EDUKIM
COVID 19	ËSHTË SËMUNDJE E SHKAKTUAR NGA GRUPI VIRUSIT CORONAVIRUS
FCD	FONDACIONI "QENDRA PËR DEMOKRACI", SERBI
GADC	QENDRA "ALEANCA GJINORE PËR ZHVILLIM"
ILO	ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE E PUNËS
LIVNO	QENDRA PËR BASHKËPUNIM CIVIL, BOSNJË
KKP	KËSHILLI KOMBËTAR I PUNËS
KPTHN	KOMBINATI I PËRPUNIMIT TË THELLË TË NAFTËS
MFE	MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
PEN	RRJETI BASHKËMOSHATARËVE EDUKATORË, KOSOVË
SIDA	ORGANIZATA NDËRKOMBËTARE PËR ZHVILLIM SUEDEZE
SPUATT	SINDIKATA E PAVARUR E USHQIMIT, AGROTURIZMIT, TREGTISË, TURIZMIT
SKOT	SINDIKATA KOMBËTARE E OPERATORËVE TELEFONIKË
SPSHSH	SINDIKATA E PUNONJËSVE TË SHËRBIMIT SHËNDETËSOR
SSPHSH	SINDIKATA E SHËRBIMEVE POLICORE TË SHQIPËRISË
SRNSH	SINDIKATA E RE E NAFTËTARËVE TË SHQIPËRISË
SPSHP	SINDIKATA E PUNONJËSVE TË SHËRBIMEVE PUBLIKE
UET	UNIVERSITETI EVROPIAN I TIRANËS
VKM	VENDIM I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Të nderuar sindikalistë dhe lexues!

Qendra për Të Drejtat në Punë (CLR) nëpërmjet një analize dhe studimi të kujdesshëm publikon këtë dokument përmbledhës ku synon të prezantojë të gjitha problematikat dhe arritjet lidhur me zhvillimet e mbartura përsa i përket të drejtave në punë dhe dialogut social në Shqipëri për periudhën 2019-2020.

Vjetari “**ZHVILLIMET DHE NDRYSHIMET LIGJORE TË TË DREJTAVE NË PUNË DHE DIALOGUT SOCIAL**” 2019 -2020 synon të paraqesë për publikun dhe gjithë të interesuarit, një panoramë të gjerë të çështjeve social-ekonomike dhe politikave të punësimit, legjislacionit të punës me fokus të veçantë në të gjitha aspektet e mbrojtjes së të drejtave në punë të punëmarrësve, duke përfshirë të drejtën e organizimit kolektiv, dialogun social, mbrojtjen dhe sigurinë në punë, mbrojtjen nga diskriminimi dhe gjithë politikat gjinore në punësim. Vjetari synon gjithashtu të japë një informacion të gjerë mbi zhvillimet në praktikë dhe terren në fushën e sindikalizmit dhe të të drejtave në punë. Si i tillë, ky Vjetar orvatet të ngërthejë në një analizë përshtuese dhe evidentuese, ndryshimet më domethënëse të ndodhura në fushat kryesore të politikave të përfshira në Kapitullin 19 të Acquis Communautaire të Bashkimit Evropian.

Aspekti kryesor që synon një publikim në formatin e Vjetarit është informimi i punëmarrësve, sindikatave dhe organizatave të shoqërisë civile mbi ndryshimet ligjore dhe praktike në lidhje me çështjet e punës dhe përfshirjen më të madhe të tyre në sigurimin e respektimit të të drejtave në punë. Ky Vjetar i shërben edhe insitucioneve ligjzbatuese, të cilët kanë një burim të përmbledhur informacioni në ndihmë të zbatimit të ndryshimeve të ligjit. Vjetari u shërben gjithashtu të gjitha organizatave të shoqërisë civile dhe komunitetit të donatorëve për një ndërgjegjësim më të madh mbi atë çfarë po ndodh në Shqipëri në lidhje me të drejtat në punë dhe nxitje për një përfshirje më domethënëse të tyre në këtë fushë. Të drejtat në punë janë të drejta të njeriut dhe të gjithë bashkë kemi një rol të rëndësishëm për të luajtur në sigurimin e këtyre të drejtave.

Në tërësinë e ndryshimeve ligjore të miratuara nga Kuvendi i Shqipërisë përgjatë vitit 2019-2020 prezantohen më poshtë sqarime për tre ligje të ndryshme si dhe 10 Vendime të Këshillit të Ministrave. Ndryshimet ligjore përmbledhtasi kanë lidhje me zhvillimin social dhe ekonomik të vendit duke iu dhënë mundësi emigrantëve që kthehen në Shqipëri të integrohen, si dhe lidhen me koordinimin e skemave të mbrojtjes shoqërore, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe vendeve të tjera. Ndërsa ndryshimet nënligjore, të miratuara nga Këshilli i Ministrave kanë lidhje me korigjime të akteve të mëparshme lidhur me punëdhënësit dhe zyrat e punësimit. Dy vendime të reja janë të lidhura me kritere për pjesëmarrje në kurset e formimit profesional, si dhe pagesat që përfitohen nga të ardhurat nga papunësia.

Një vend të veçantë në VJETARIN PËR PUNËN 2019-2020 zënë edhe zhvillimet që kanë ndodhur lidhur me zbatimin për Statusin e Naftëtarit, të miratuar në vitin 2017, si dhe qasja që ka mbajtur Këshilli Kombëtar i Punës mbi rolin që duhet të luajë në tregun e punës dhe në funksion të drejtpërdrejtë të mbrojtjes së të drejtave në punë të punëmarrësve dhe dialogut me organizatat e punës.

Vjetari sjell gjithashtu në mënyrë të integruar por jo shteruese, aktivitetin më të rëndësishëm sindikal dhe organizatave të shoqërisë civile brenda periudhës kohore të studiuar, si dhe gjithë nismave dhe arritjeve domethënëse të aktorëve më në zë të mbrojtjes dhe promovimit të të drejtave në punë dhe punës së denjë në vend. Ai evidenton praktikën më të mira të dy viteve të fundit lidhur me organizimin kolektiv dhe solidaritetin sindikal, dialogun social, kontraktimin kolektiv, sigurinë dhe shëndetin në punë, mbrojtjen nga diskriminimi në marrëdhëniet e punës; garantimin e barazisë në punë mes grave dhe burrave, fuqizimin e grave në vendin e punës, si dhe advokimin në mbështetje të grupeve shoqërore të cenuara dhe të brishta në tregun e punës. Ajo që vihet re gjatë dy viteve të fundit është një rivitalizim i lëvizjes sindikale me një numër sindikatash të reja të krijuara dhe grupe punëmarrësish të angazhuar aktivisht për të mbrojtur të drejtat e tyre. Megjithatë, mbetemi shumë larg një lëvizjeje të fortë dhe të qëndrueshme sindikale.

Analiza e këtij publikimi është e mbështetur në burime të ndryshme informacioni zyrtare, të tilla si faqja zyrtare e Kuvendit të Shqipërisë, faqja zyrtare e qeverisë shqiptare, si dhe burime të tjera alternative që përfshijnë publikime dhe komente lidhur me tregun e punës, të cituara në fund të çdo faqeje me citim në Vjetar. Ky publikim mbështetet gjerësisht edhe në përvojën në terren të organizatave sindikale dhe shoqërisë civile në lidhje me çështjet e punës gjatë periudhës 2019-2020.

*Qendra për të Drejtat në Punë, CLR synon që ta përdorë këtë informacion për të ndihmuar në përmirësimin e dialogut midis punëmarrësve dhe organizatave me qeverinë, si dhe synon që nëpërmjet ekspertizës për problematikat ligjore dhe zbatimin e tyre të ndërtojë një traditë në publikime në vijimësi të materialeve të tilla dhe të ngjashme me to.*

Ju urojmë lexim të frutshëm!

**Qendra për të Drejtat në Punë, CLR**

## 1. Tregu i punës 2019-2020

Punësimi sipas INSTAT pati një rritje gjatë vitit 2019, pësoi një tkurrje të fortë përgjatë 2020 për shkak të ndikimit të pandemisë në pjesën dërrmuese të aktivitetit ekonomik në vend. Situata e pandemisë përcolli trysni për vazhdimin e marrëdhënieve të punës dhe pagesës së punëmarrësve nëpërmjet organizatave të punonjësve si dhe faktorëve mbështetës politikë në përkrahje të tyre.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2020:

- shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 59,6 %, ndërkohë që në fund të vitit 2019 ishte 61,6 %;
- ritmi vjetor i punësimit për popullsinë 15 vjeç e lart, nga tremujori i dytë i vitit 2019 në tremujorin e dytë të vitit 2020, është -3,6 %;
- 18,5 % e popullsisë ekonomike jo-aktive dhe në moshë pune (15-64 vjeç) ishin duke përmbushur detyrat shtëpiake - 11,1 % e saj ishte në pension ose pension të parakohshëm, ndërsa 11,4 % në paaftësi të përhershme.

Në terma vjetorë, ritmi i punësimit ka pësuar rënie me 3,7 % në sektorin e bujqësisë, me 3,7 % në sektorin e industrisë dhe me 3,4 % në sektorin e shërbimeve. Ndërsa, në terma vjetorë në fund të 2019, rritja e punësimit sipas sektorëve kryesorë të ekonomisë ishte 6,4 % në sektorin e industrisë, 2,3 % në sektorin e shërbimeve dhe 2,3 % në sektorin e bujqësisë.

Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, punësimi për popullsinë 15 vjeç e lart u ul me 2,6 %. Punësimi pësoi ulje në sektorin e bujqësisë me 1,1 %, në sektorin e industrisë me 6,2 % dhe në sektorin e shërbimeve me 2,3 %.

Në tremujorin e dytë 2020, shkalla zyrtare e papunësisë në Shqipëri është 11,9 %. Në terma vjetorë, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,4 pikë përqindje. Krahasuar me tremujorin e mëparshëm, shkalla zyrtare e papunësisë u rrit me 0,5 pikë përqindje.

Shkalla e pjesëmarrjes së vajzave dhe grave është një nga pak elemente të tregut të punës me të cilën Shqipëria është lider në rajonin e Ballkanit Perëndimor, me një nivel pjesëmarrje prej 53.3%. Ky standard i arritur kryesisht falë politikave të zbatuara, por dhe nëpërmjet angazhimit dhe lobimit të organizmave të shoqërisë civile dhe sindikatave.

## 2. Situata pandemike Covid 19 dhe reagimi i tregut

Shkalla e pjesëmarrjes në punësim e cila është rritur me më shumë se 1 pikë përqindjeje në vitin 2019, u pasua nga një tërheqje e fortë në tremujorin e parë 2020, pasi filloi kriza, ku thuajse një e dyta e popullatës në moshë pune ishte jo aktive. Kështu, numri i personave të papunë u rrit deri në fund të muajit Prill 2020 me të paktën 25 përqind, që shënon shifër të ngjashme edhe për gjithë rajonin e Ballkanit Perëndimor. Kjo pasqyron pjesërisht futjen në

rregulla të punonjësve joformalë të cilët janë regjistruar për të përfituar nga sigurimet shëndetësore dhe nga pagesa të tjera sociale.

Bizneset private kanë kaluar prej disa muajsh drejt aplikimit të masave mbrojtëse duke ndryshuar orarin e punës, kanë bërë shkurtime të përkohshme të orëve të punës, kanë detyruar punonjësit të marrin lejen vjetore, leje pa të drejtë rroge dhe ka pasur edhe shkurtime të vendeve të punës për të përballuar rënien e operacioneve apo madje edhe mbylljen e detyruar. Kufizimet mbi lëvizjen dhe distancimi fizik kanë cenuar ofertën dhe kërkesën e krahut të punës, transportin dhe udhëtimet në mënyrë të paprecedentë. Pavarësisht nga paketat e mbështetjes shtetërore, bizneset po vijnë të jenë me humbje, çka rrezikon operacionet dhe aftësinë e tyre paguese.

### **3. Ndikimi nga pandemia dhe masat që u ndërmoren nga qeveria**

Sektorët më të prekur nga rënia drastike e produktit janë hoteleri-turizmi dhe shërbimet ushqimore, disa sektorë prodhimi, tregtia me shumicë dhe një pjesë e tregtisë me pakicë, si dhe pasuritë e paluajtshme dhe aktivitetet e biznesit. Në këto sektorë janë të punësuar mbi gjysma e tregut të punës, ku karakteristika kryesore e këtij grupi punonjësish është paga e ulët dhe niveli i ulët i specializimit, sidomos në rastin e hoteleri-turizmit, shërbimeve ushqimore dhe në tregtinë me pakicë.

Punonjësit e angazhuar në aktivitetet e shpërndarjes së ushqimeve dhe tregtia e farmaceutikeve e vijuan punën, por u përballën me risqe më të mëdha shëndetësore në punë.

Në tërësinë e tregut të punës, më të prekurat janë bizneset e vogla dhe të mesme, si edhe bizneset joformale. Efekti të veprimtaritë që sjellin të ardhura është sidomos i rëndë për punonjësit e pambrojtur dhe grupet më të cenueshme në ekonominë joformale. Tregjet e punës ku vetëpunësimi dhe punësimi joformal dhe i përkohshëm është shpërpjesëtimor kanë të ngjarë të përballen më shumë me humbjen e vendeve të punës, çka do të duhet të trajtohet nëpërmjet sistemeve të mbrojtjes sociale.

Edhe pse u futën në zbatim masa për t'i nxitur ndërmarrjet të ruajnë ose të krijojnë vende pune, si dhe krahas masave të mbrojtjes së shëndetit, lehtësimeve fiskale, skemave të garancive, linjave të subvencionuara të kreditimit dhe masave të asistencës sociale, si edhe pagesa më të larta të papunësisë me kritere të lehtësuara, përfitimi për sa kohë që janë duke u zbatuar ende masa kufizuese të shpallura nga qeveria, si dhe duke patur parasysh riskun e përsëritjes së pandemisë është me rëndësi të monitorohen efektet dhe t'u bëhen përshtatje masave sipas nevojës.

Nga kriza e punës shkaktuar nga COVID-19 vijnë të preken më së shumti punonjësit meshkuj mbi 30 vjeç me arsim të mesëm, të cilët punojnë në biznese të vogla dhe të mesme dhe me kontrata definitive.

Shkalla e rritjes së papunësisë do të varet nga efektiviteti i masave të politikave për rritjen e kërkesës për fuqi punëtore. Reagimet e menjëhershme të politikave duhet të sigurojnë masa lehtësuese për punonjësit dhe për ndërmarrjet për të mbrojtur mjetet e jetesës dhe bizneset me rentabilitet ekonomik, sidomos në sektorët e goditur më rëndë, duke përshtatur kushtet për një rimëkëmbje të menjëhershme me vende pune me t'u vënë nën kontroll pandemia.

Por, përtej problemeve të shumta të krijuara nga ndikimi global i pandemisë, në Shqipëri vijojnë të ekzistojnë problemet e trashëguara të informalitetit të lartë të tregut të punës, si dhe nivelit të ulët të shkallës së kontribuesve në raport me përfituesit. Kështu, gjatë vitit 2019, shkalla e mbulimit të popullsisë në moshë punë (kontribues /popullsi në moshë pune) nuk kaloi dot mbi nivelin e 43%.

Kjo sfidë e informalitetit, megjithë veprimet e ndryshme nga qeveria nuk ka ndikuar dot në transformimin e tregut të punës dhe formalizimit të tij përtej ndryshimeve të vogla dhe që nuk mjaftojnë për të patur një skemë përfitimi në përmasa të krahasueshme me vendet e Ballkanit Perëndimor.

#### 4. Ndryshimet ligjore dhe reagimi nëpërmjet akteve nga qeveria

##### 4.1. Ndryshimet ligjore dhe nënligjore, 2019

Viti 2019 karakterizohet nga miratimi i ligjeve bazë organike me peshë në tregun e punës si dhe të qasjeve që evidentojnë mandatin e qeverisjes aktuale. Ndërhyrjet ligjore dhe nënligjore më kryesore janë më poshtë:

Një ligj mjaft i rëndësishëm dhe që ka shtrirë tashmë ndikimin e tij në funksion të të drejtave në punë është **Ligji për nxitjen e punësimit**<sup>1</sup>.

Një nga objektivat e këtij ligji është zgjerimi i kategorive që përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit, duke shtuar personat fizikë si përfitues si dhe grupet e veçanta (shtresat me vështirësi për t'u integruar në tregun e punës. Ligji zëvendësoi ligjin e 1995 duke vënë qëllim realizimin e:

- Krijimit të mundësive dhe shanseve të barabarta për punësim qytetarëve shqiptarë;
- Ofrimit të shërbimeve të punësimit (trajtime, këshillime, aftësime);
- Rritjes së përgjegjësisë së institucioneve publike të cilat nuk kanë më detyrë thjesht të deklarojnë vendet e lira të punës, por të ofrojnë edhe të gjithë formimin profesional të punëkërkuësve, si dhe;
- zgjerimit të rrethit të kategorive që përfitojnë nga programi i nxitjes së punësimit

Të gjitha institucionet publike dhe ato private detyrohen, që 1 në 25 persona të të punësuarve të tyre, ta kenë nga kategoria e personave me aftësi të kufizuara. Kush nuk mund ta bëjë këtë, është i detyruar që të derdhë çdo muaj, 100 për qind të pagës minimale në Fondin Social, fond i dedikuar për nevojat e personave me aftësi të kufizuara. Për ndërmarrjet me më shumë se 25 persona, 1 në 50 punonjës duhet të punësohet një individ me aftësi të kufizuara. Punëdhënësit që nuk e bëjnë këtë, do duhet të derdhin një kontribut për llogari të Fondit Social të Punësimit, në masën 100% të pagës minimale në shkallë vendi, për çdo person me aftësi të kufizuara që duhet të kishin punësuar.

Ligji “Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”<sup>2</sup>, sipas mbulimit të tij përcakton tre *tip përfitime pensioni*, (a) Pension për shkak të profesionit (llojit të punës), (b) Shtesë mbi pensionin e pleqërisë; (c) Shtesë mbi pensionin e invaliditetit.

<sup>1</sup> Miratuar ligji nr. 15/2019, datë 13.03.2019 “Për nxitjen e punësimit”. Ka hyrë në fuqi më 18 Prill 2019, pas publikimit në Fletoren Zyrtare nr. 43/2019, datë 03.04.2019.

<sup>2</sup> Ligji Nr.29/2019, datë 23.05.2019



Një vendim i rëndësishëm i qeverisë dhe me peshë përtej mandatit qeverisës është edhe miratimi i **Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale dhe Plan Veprimit, 2020-2023**<sup>3</sup>. Strategjia orienton ndërhyrje prioritare nëpërmjet zbatimit të programeve të ndihmës ekonomike, sistemit të vlerësimit të aftësisë së kufizuar dhe të shërbimeve shoqërore e shëndetësore, duke përfshirë mbrojtjen e familjeve, fëmijëve dhe popullatës bazuar në skema makro (në nivel kombëtar) dhe në nivel mikro (në nivel bashkie, qyteti, fshati, komuniteti, familje), si dhe procesin e rikthimit drejt tregut të punës me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës për çdo individ dhe familje.

Një vendim tjetër i qeverisë i fund vitit 2019<sup>4</sup> aktivizon tashmë **mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin e punësimit të individëve** dhe të anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike. Qëllimi i këtij vendimi të qeverisë është siguri i riintegritit social të tyre, nëpërmjet koordinimit dhe zbatimit të një programi kombëtar të daljes nga skema e ndihmës ekonomike.

Ky është një akt që është ndikuar në mënyrë direkte nga studimet dhe propozimet e bëra gjatë vitit 2019 nga CLR duke patur një dialogu të vazhdueshëm me institucionet e qeverisë dhe një rol aktiv edhe në jetën e përditshme të lobimit për mbrojtjen e të drejtave në punë.

#### 4.2. Ndryshimet ligjore dhe nënligjore, 2020

Në vitin 2020, ndërhyrjet ligjore kanë qenë më të shumta në numër për arsye edhe të masave për përballimin e situatës pandemike. Ndryshimet ligjore dhe nënligjore më kryesore janë më poshtë:

**Akt Normativ Nr.6, datë 21.03.2020**<sup>5</sup>, parashikon ndër të tjera masat ekonomike dhe sociale, ku veçojmë akordimin e një fondi prej 6.5 miliardë lekësh në zërin e ri “Kontingjenca për paketën sociale antiCOVID-19”, e cila do të përdoret me vendim të Këshillit të Ministrave. Ky fond vlejti për financimin e masave me karakter social, në funksion të lehtësimit dhe mbështetjes së punëmarrësve dhe/ose shtresave të tjera të prekura nga pezullimi i proceseve të punës në shkallë vendi. Konkretisht, (a) Për shtresat në nevojë; (b) Për të papunët, si rrjedhojë e situatës nga Covid-19; (c) Për mbështetje të ndryshme të komuniteteve dhe sektorëve, që rezultojnë më të dëmtuarit, për shkak të situatës.

**Akt Normativ Nr.15, datë 15.04.2020**<sup>6</sup>, u paraqit për miratim në kushtet kur, në vendin tonë, vijonte situata e pandemisë Covid-19 dhe e nevojës emergjente për zbutjen e efekteve të saj tek punonjësit dhe bizneset. Ai u miratua për financimin e paketës së dytë të masave të ndërmarra nga Këshilli i Ministrave kundër kësaj pandemie. Nëpërmjet këtij akti normativ u akordua një fond prej 7 miliardë lekësh në zërin “Kontingjenca për paketën sociale anti COVID”. Ky fond është përdorur për të financuar masat me karakter social, si mbështetja e

<sup>3</sup> VKM Nr.866, datë 24.12.2019 “Për Miratimin e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale, 2020–2023, dhe të planit të veprimit në zbatim të saj.

<sup>4</sup> VKM Nr.882, datë 24.12.2019 “Për mekanizmin e bashkërendimit ndërinstitucional të punës për referimin për punësim të individëve dhe anëtarëve në moshë aktive pune të familjeve përfituese të ndihmës ekonomike”

<sup>5</sup> Akti Normativ nr.6, datë 21.03.2020 “Për disa ndryshime dhe shtresat në Ligjin nr.88/2019 “Për Aftësitë të Kufizuara” miratuar me Ligjin Nr.27/2020

<sup>6</sup> Akti normativ, i Këshillit të Ministrave, nr.15, datë 15.4.2020, miratuar me Ligjin 50/2020

personave të prekur nga pezullimi i proceseve të punës (të cilët kanë qenë të punësuar në biznesin e madh dhe të vogël), si dhe e shtresave të tjera në nevojë.

**Akt Normativ Nr.28, datë 02.07.2020<sup>7</sup>**, ku përveç qëllimit të përshtatjes së treguesve të buxhetit me situatën fiskale të krijuar nga efekti i pandemisë mori vendim edhe për rritjen me 200 milionë lekë të fondit të planifikuar për skemën e papunësisë, si rrjedhojë e parashikimeve dhe pritshmërive deri në fund të vitit 2020.

**Vendim Nr.207, datë 10.3.2020<sup>8</sup>**, ku u mor vendim për (a) dhënien e shpërblimit mujor, në masën 125 000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë, për personelin mjekësor, specialistë të shëndetit publik që merren me epidemiologjinë, infermierë dhe specialistë të shërbimit laboratorik, të angazhuar në diagnostikimin dhe trajtimin mjekësor të personave të prekur nga infeksioni i shkaktuar nga COVID-19, Si dhe (b) dhënien e shpërblimit mujor, në masën 65 000 (gjashtëdhjetë e pesë mijë), lekë, për personelin mbështetës.

**Vendimi Nr.254, datë 27.03.2020<sup>9</sup>**, për (a) dhënie ndihme financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID19, (b) dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike, (c) dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

**Vendimi Nr.305, datë 16.04.2020<sup>10</sup>**, për (a) dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore mbi 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që kanë mbyllur aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave, (b) dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të ish-punësuarit në subjektet që janë lejuar të kryejnë aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave deri në datën 10 prill 2020 (c) dhënie ndihme financiare prej 40 000 (dyzet mijë) lekësh për të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Vendimi Nr.608, datë 29.07.2020, i ndryshuar<sup>11</sup>** ishte një akt që përcaktoi procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19, nga data 10 mars 2020 deri në datën 23 qershor 2020

<sup>7</sup> Akti normativ, nr.28, datë 02.07.2020, miratuar me Ligjin 50/2020 Akti normativ, i Këshillit të Ministrave, nr.15, datë 15.4.2020, miratuar me Ligjin 50/2020

<sup>8</sup> VKM Nr.207, datë 10.03.2020 “Për dhënien e shpërblimit mujor, për personelin mjekë, infermierë dhe punonjës të tjerë”

<sup>9</sup> VKM Nr.254, datë 27.03.2020 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të masës financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 milion lekë, ndihmës ekonomike dhe pagesës të së ardhurës nga papunësia, gjatë periudhës së fatkeqësisë natyrore, të shpallur si pasojë e Covid-19”, i ndryshuar me VKM Nr.284, datë 10.04.2020

<sup>10</sup> VKM Nr.305, datë 16.04.2020 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës së përfitimit të masës financiare për të punësuarit aktualë dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19”, i ndryshuar me VKM 341, date 23.04.2020, si dhe VKMNr.423, date 28.05.2020

<sup>11</sup> VKM Nr.608, datë 29.07.2020 “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit të personave të dalë të papunë si pasojë e COVID-19”, ndryshuar me VKM Nr. 699, datë 10.09.2020 “ Për një ndryshim në vendimin nr. 608, datë 29.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për procedurat, kriteret dhe rregullat për

Phone

+355 69 402 0057

Address

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba" Shk. 4, Ap. 7

Website

www.clr.al

**Vendimi Nr.651, datë 13.08.2020<sup>12</sup>**, që u zbatua për dhënien e ndihmës financiare prej 26.000 (njëzet e gjashtë mijë) lekësh, për shkak të situatës së krijuar nga COVID-19, për të punësuarit apo ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas.

**Vendimi Nr.1025, datë 16.12.2020** “Për Përcaktimin e Pagës Minimale në shkallë Vendi”. Sipas këtij vendimi, **për efekt të llogaritjes së kontributeve të sigurimeve shoqërore**, paga bruto mujore, do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore, e barabartë me **30,000** (tridhjetë mijë) lekë dhe deri në **132,312** (njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, për personat e punësuar;
2. Jo më pak se paga minimale, e barabartë me **30,000** (tridhjetë mijë) lekë dhe sipas përcaktimit të vetë personit, deri në **132,312** (njëqind e tridhjetë e dy mijë e treqind e dymbëdhjetë) lekë, për personat e vetëpunësuar;
3. E barabartë me pagën minimale mujore prej **30,000** (tridhjetë mijë) lekë, për punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuar punon e bashkëjeton ligjërisht.

Gjithashtu, **për efekt të llogaritjes së kontributeve të detyrueshme të sigurimit shëndetësor**, paga mujore do të jetë:

1. Jo më pak se sa paga minimale mujore në shkallë vendi, prej **30.000** (tridhjetë mijë) lekë dhe deri në shumën e pagës bruto, sipas deklaratës së listëpagesës, për personat e punësuar;
2. Sa dyfishi i pagës minimale në shkallë vendi, prej 60.000 (gjashtëdhjetë mijë) lekë, për personat e vetëpunësuar dhe punonjësit e papaguar të familjes me të cilët i vetëpunësuar punon e bashkëjeton.

zbatimin e programit të nxitjes së punësimit nëpërmjet punësimit të personave të dalë të papunë, si pasojë e COVID-19”

<sup>12</sup> VKM nr. 651, datë 13.08.2020 “Për përcaktimin e pagës minimale, të dokumentacionit dhe të masës së përfitimit të ndihmës financiare, si pasojë e COVID-19 për të punësuarit dhe ish-të punësuarit në subjektet e transportit publik, qytetas dhe ndërqytetas”. Publikuar në Fletoren Zyrtare Nr.150, datë 17 Gusht 2020

## 5. Aktivitetet kryesore sindikaliste dhe të organizatave që merren me çështjet e punës gjatë 2019 dhe 2020

### 5.1. Aktivitetet dhe jeta sindikaliste, 2019

Qendra për të Drejtat në Punë, mban një linjë veprimi aktive dhe bashkëpunuese me gjithë sindikatat e angazhuara për mbrojtjen e të drejtave në punë duke synuar (a) mbrojtjen ligjore dhe asistimin me ndihmë teknike të grupeve të ndryshme, (b) forcimin e kapaciteteve brenda sindikatës dhe dialogun me punonjësit e rinj, përfshirë barazinë gjinore, (c) organizimin e forumeve informuese, edukuese dhe iniciuese të nismave ligjore dhe nënligjore në mbrojtje të të drejtave në punë. Një aktivitet mjaft i veçantë dhe i spikatur është pikërisht krijimi dhe forcimi i institucionit edukativ “Akademia e Punës”

Në **Mars 2019**, CLR e GADC si pjesë e shoqërisë civile, së bashku me partnerët socialë si BPSH, SRNSH, BIZNES –ALBANIA, deklaruan njëzëri nevojën e miratimit të Konventës së ILO - s "Eliminimi i Dhunës dhe Ngacmimeve në Botën e Punës ". Pjesëmarrës të tjerë të rëndësishëm si Avokati i Popullit, përfaqësues të nivelit të lartë të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë, etj u shprehën dakort dhe në mbështetje të kësaj nisme. ILO Shqipëri theksoi rëndësinë e kësaj Konvente dhe hapat që duhen ndjekur nga institucionet publike, partnerët socialë dhe organizatat e tjera të punës, pas aprovimit dhe ratifikimit të saj.

Me rastin e **1 Majit**, Ditës Ndërkombëtare të Punëtorëve, përfaqësuesit e SRNSH nga i gjithë vendi u mbledhën në qytetin naftëtar të Kuçovës, ku diskutuan problematikat që shqetësojnë naftëtarët shqiptarë duke firmosur një Peticion drejtuar kryeministrit të Shqipërisë Z. Edi Rama, me kërkesat e tyre. Naftëtarët kërkuan nga qeveria të mbajë qëndrim përgjegjës në lidhje me nismën që u ndërмор për përgatitjen e projektligjit për trajtimin financiar shtesë të profesioneve të vështira. Pas diskutimeve të shumta për padrejtësitë e mëdha dhe indiferencën vrastare të shtetit ndaj naftëtarëve në të kaluarën, naftëtarët i kërkuan qeverisë korigjimin e ligjit të statusit të naftëtarëve, duke mbajtur premtimin e dakordësuar në 26 Prill 2018, për një shtesë financiare dinjitoze, 40% të pagës minimale si rritje të pensionit aktual. Në fund të takimit, të gjithë naftëtarët e pranishëm firmosën peticionin me kërkesat e tyre drejtuar kryeministrit Rama dhe gjithë instancave përgjegjëse shtetërore.

Në **muajin Maj 2019**, me një lobim ndër shumë aktorë të tjerë të botës së punës në vend, por me një rol promotor nga CLR, u kalua në diskutime në komisionet parlamentare një projekt ligj i ri **“Për trajtimin financiar, suplementar, të punonjësve që kanë punuar në miniera, në nëntokë, të punonjësve të industrisë së naftës dhe gazit dhe të punonjësve që kanë punuar në metalurgji”**. Gjithë periudha deri në momentin e futjes në kalendar dhe në diskutime ishte një përpjekje e gjatë me debate, dialog si dhe asistencë direkte teknike për një përmirësim të draftit të mëparshëm.

Qëllimi kryesor i përpjekjeve të CLR ishte mbulimi me përfitime, përpara kohës së mbushjes së moshës për pension, si dhe përfitime shtesë, mbi ato që akordohen nga ligji nr.7703, datë 11.5.1993, “Për Sigurimet Shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, për tre kategori mjaft të veçanta punonjësish, të cilët kanë punuar në miniera, në nëntokë, në industrinë e naftës, si dhe në punë me një shkallë vështirësie shumë të lartë në metalurgji.

## 5.2. Aktivitetet e sindikatave dhe organizatave që merren me çështjet e punës, 2020

*Fillimi i vitit 2020 ishte mjaft aktiv, siç edhe vijoi për gjithë vitin, pavarësisht mbylljes disa mujore si pasojë e Covid 19. Pandemia duke ndryshuar kushtet e organizimit të punës dhe trajtimit financiar të punonjësve në shumë sektorë, solli natyrshëm nevojën e intensifikimit në disa drejtime të aktivitetit sindikal dhe të tjerë aktorëve të botës së punës.*

*Më poshtë, një kronologji e aktiviteteve më të spikatura të vitit 2020*

**Në Janar 2020**, minatorë dhe aktivistë të mbështetur nga Sindikata e Bashkuar e Minatorëve të Bulqizës protestuan në Tiranë përballë institucioneve kryesore shtetërore për të drejtat e tyre të punës. Duke marrë shkas nga ky aksion sindikal, CLR reagoi publikisht në rrjetet e saj sociale duke iu bërë thirrje sindikatave që pretendojnë përfaqësimin e punonjësve në kompaninë "Albchrome" në Bulqizë, për t'i lënë ëmënjatë dasitë dhe luftën e ndërsjellë dhe pavarësisht shkallës së pretenduar të përfaqësimit, të bëhen bashkë për të drejtat e minatorëve, si mënyra e vetme për të maksimalizuar forcën e puneëtorëve në këtë kompani. *“Koha është tani për të treguar një shembull solidariteti dhe bashkëpunimi i cili do t'i shërbente maksimalisht forcimit të pozitës së punëtorëve në kompaninë Albchrome dhe do të ishte shembull frymëzues edhe për sindikata e punonjës në sektorë të tjerë të ekonomisë”*, shprehet publikisht CLR për këtë rast.

**Gjatë janarit 2020**, CLR ka vijuar advokimin publik për adresimin e konfliktit kolektiv në Minierën e Bulqizës, duke i dërguar argumentimet përkatëse pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, për të verifikuar nëse rasti i largimeve nga puna të punonjësve pjesë e sindikatës përbën diskriminim të mundshëm për shkak të përkatësisë në një grupim të posaçëm.

**Në shkurt 2020**, SRNSH ka kërkuar nga institucionet përkatëse të linjës nisjen e procedurës së ndërmjetësimit dhe pajtimit për konfliktin kolektiv të punës midis përfaqësuesit të punëdhënësit të kompanisë Albpetrol në Kuçovë dhe Sindikatës. Përfaqësuesi i sindikatës është transferuar pa marrë pëlqimin e tij ose të sindikatës në një detyrë tjetër që praktikisht ia vështirëson atij ushtrimin e detyrës si përfaqësues i sindikatës. Çështja u trajtua nga Zyra Rajonale e Ndërmjetësimit Fier dhe u zgjidh në favor të përfaqësuesit të sindikatës i cili u rikthye në vendin e mëparshëm të punës. Është koha që strukturat e ndërmjetësimit dhe pajtimit të intensifikojnë rolin e tyre në procesin e ndërmjetësimit dhe pajtimit të konflikteve kolektive të punës dhe përmirësimin e të drejtave të punëmarrësve në punë.

SRNSH advokon përmes reagimeve të njëpasnjëshme publike në mbështetje të punonjësve të ish kompanisë "Armo", KPTHN Ballsh, për mospagimin e pagave të punonjësve për muaj me radhë dhe mos shlyerjen e detyrimeve për pagat e prapambetura të cilat në shumicën e rasteve janë fituar edhe me vendime gjyqësore të formës së prerë. Pavarësisht kompleksitetit të çështjes dhe pavarësisht se punonjësit e kësaj rafinerie nuk janë pjesë e SRNSH, sindikata vazhdoi ta ndjekë situatën me shqetësim duke i kërkuar të gjitha institucioneve shtetërore, përfshirë ministrinë përkatëse dhe gjithë strukturave shtetërore, të ndërmerren të gjitha hapat ligjore dhe institucionale për zgjidhje të qëndrueshme të problematikës së këtyre punonjësve, larg zgjidhjeve sipërfaqësore dhe sa për të kaluar momentin që janë ndërmarrë të cilat CLR i ka denoncuar vazhdimisht sepse bëjnë që situata të tilla të përsëriten kohë pas kohe. Është plotësisht e pajustificuar që institucionet shtetërore nuk arrijnë të garantojnë minimalisht që punonjësve të kësaj kompanie në Ballsh, Fier, Kuçovë, Poçem, Prrerjas t'u paguhet paga mujore sipas legjislacionit të punës edhe pse i kanë të gjithë instrumentat ligjorë dhe

institucionalë për këtë qëllim. Nga ana tjetër, SRNSH përtej mbështetjes publike, vazhdoi dialogun me përfaqësues të punonjësve të kësaj rafinerie dhe tregoi solidaritet dhe bashkëpunim të sinqertë me ta në funksion të mbrojtjes dhe përfaqësimit dinjitoz e të vërtetë të të drejtave të punonjësve të përfshirë.

**Në Shkurt, CLR** ka reaguar publikisht ndaj qëndrimit të qeverisë shqiptare e cila ka mbajtur një pozicion thellësisht pasiv në konfliktin e punës së punonjësve të rafinerisë së naftës në Ballsh. Ndërkohë, kompania që administron aktualisht rafinerinë dhe që në mënyrë të pashpjegueshme ka marrë vetëm të drejtat dhe jo edhe detyrimet, është fshehur pas faktit që e ka patur të pamundur të vazhdojë aktivitetin për shkak se nuk furnizohet me naftë bruto që është lënda e parë për funksionimin e rafinerisë dhe për këtë ka luajtur rolin e viktimës duke u justifikuar në mënyrë dinake tek punonjësit dhe duke i kërkuar qeverisë ta zgjidhë situatën. Nga ana tjetër, kjo kompani nuk iu ka shlyer ende punonjësve disa paga të prapambetura gjatë kohës që rafineria nuk ka qenë në funksionim normal, të cilat duhet t'ia kishte shlyer me kohë dhe jo si paga minimale por si paga të plota. Për të mos folur pastaj për pagat e prapambetura të punonjësve të fituara me vendime gjyqësore të formës së prerë për të cilat askush nuk ka marrë përgjegjësi. Kësaj shtate, qeveria si institucion përgjegjës nuk ka arritur t'i japë një zgjidhje të qëndrueshme dhe afatgjatë në funksion të interesit publik.

Po në muajin **Shkurt 2020**, CLR ka reaguar për dobësimin e ndjeshëm dhe në mënyrë të pashpjegueshme të qëndrueshmërisë në marrëdhëniet e punës për inspektorët përgjegjës për kontrollin ushqimor në Republikën e Shqipërisë. Me ndryshimet e fundit ligjore, marrëdhënia e punës për inspektorët e institucionit përgjegjës për inspektimin e ushqimit u ndryshua pa asnjë konsultim paraprak duke hequr statusin e nëpunësit civil për inspektorët përgjegjës për kontrollin e ushqimit dhe duke cenuar njëkohësisht edhe një standard të arrirë prej kohësh për këtë kategori punonjësish. CLR shprehet se reformat në këtë sektor janë të domosdoshme dhe të mirëpritura edhe përse i përket burimeve njerëzore, por në asnjë rast kjo nuk mund të bëhet duke cenuar qëndrueshmërinë në punë të punonjësve dhe duke shkelur kësisoj një nga elementet thelbësore të punës së denjë. CLR e pati në vëmendje përgjatë gjithë 2020 situatën dhe ndoqi me interes ecurinë e këtij procesi dhe qëllimet e vërteta të kësaj iniciative.

Në kuadrin e bashkëpunimit, por edhe nevojës për të reaguuar në grup, **në fillim të Marsit 2020**, me fillimin e sinjaleve nga rajoni dhe vendet fqinje për përhapjen e pandemisë dhe fillimin e një risku të madh për ndryshimin e kushteve të punës, CLR ju bëri thirrje Sindikatave që funksionojnë në sektorin privat.

*“Të gjitha sindikatat që funksionojnë në sektorin privat, nëse nuk e kanë bërë deri tani, duhet të fillojnë menjëherë negociatat me punëdhënësit e kompanive private përkatëse ku ato përfaqësojnë punonjësit, me qëllim garantimin e zbatimit të Vendimit të Këshillit të Ministrave për caktimin e datave 10 deri në 23 mars ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur, edhe për punonjësit e sektorit privat!”*

*Këto negociata duhet të bëhen vetëm pasi të sigurohen se vazhdimi i punës në kompani garanton të gjitha masat paraprake të nevojshme për mbrojtjen e punonjësve nga Covid-19.*

*Në të kundërt, duhet të kërkojnë nga punëdhënësi dhe institucionet mbylljen e menjëhershme të aktivitetit të kompanisë për një periudhë deri në përfundim të emergjencës duke u dakordësuar edhe për çështjen e pagesës së punonjësve.”*

SRNSH filloi në muajin **mars 2020** bisedimet kolektive me kompaninë Albpetrol për disa të drejta për punonjësit e kësaj kompanie, të kërkuara e rikërkuara prej vitesh nga sindikata, përfshirë pagën e 13-të të sigurtë për çdo punonjës, siguracionin për të gjithë punonjësit dhe jo vetëm për një pjesë të tyre, strukturën e re e pagave të diskutuar e parregulluar prej kohësh, rritjen e pagave me afate kohore të përcaktuara qartë dhe të vendosur në kontratë brenda 3 mujorit të parë të vitit 2020, transportin për punonjësit, pagën në natyrë sa dyfishi i VKM-së, edhe pse e kundërshtuar ashpër nga KLSH, shpërblimi në momentin e marrjes së lejes vjetore, etj.

Më datë **26 mars 2020**, me argumentimin se “Albpetrol” do kryente një ristrukturim të brendshëm, me qëllim reduktimin e shpenzimeve të brendshme, shoqëria urdhëroi pezullimin nga puna të gjithë punonjësve të rinj që ishin kontraktuar prej datës 1 mars 2020. **Në 5 Maj 2020, SRNSH** reagon fort kundër vendimit të kompanisë për të reduktuar pagën e punonjësve të administratës së Albpetrol. Sindikata ngulmon që punonjësit e administratës dhe gjithë grupet e tjera të profesioneve brenda kompanisë Albpetrol të pagohen me pagën e plotë konform punës që kanë bërë. **SRNSH** u zotua publikisht që të mos lejojë diskriminimin në pagë dhe zbritje nga paga edhe për punonjësit e administratës së Albpetrol, duke u shprehur se do ta ndjekin deri në fund çdo qindarkë që iu takon punonjësve nga puna e kryer me sakrificë në kohë pandemie. Gjithashtu, sindikata shprehu angazhimin e saj maksimal për të mbështetur ndalimin e menjëhershëm të privatizimit të mëtejshëm të sektorit të naftës në Shqipëri si mënyra e vetme për të ndalur shkurtimet e vendeve të punës. Në vazhdim, **SRNSH** përmes seksionit sindikal të Kuçovës u ngrit në protestë për të kundërshtuar vendimin e Albpetrolit për uljen e pagave të naftëtarëve në masën 60 % . Naftëtarët e Kuçovës të cilët kanë punuar rregullisht gjatë muajve të parë të pandemisë ndërkohë që pjesa më e madhe e sektorëve e pezulluan aktivitetin, nuk duhet të trajtohen financiarisht me pagën e luftës. Për këtë arsye, përfaqësues të sindikatës dhe naftëtarë protestuan para zyrave të kompanisë duke refuzuar pagesën me pagë lufte ndërkohë që ata nuk e kanë ndërprerë punën asnjë ditë e madje kanë punuar nga 16 orë çdo ditë.

*"Zoti kryeministër larg duart nga Kuçova, Kuçova është e kuçovarëve"*, ishte një nga parullat që naftëtarët mbanin në duar gjatë protestës. Kreu i sindikatës së naftëtarëve në Kuçovë, Sotiraq Kristo paralajmëroi se nëse nuk ndryshon vendimi i qeverisë, naftëtarët do të hidhen në grevë.

Vetëm dy ditë më vonë në ambjentet e kompanisë "Albpetrol" në Patos, u zhvillua një takim ndërmjet përfaqësuesit të SRNSH dhe administratorit të kompanisë "Albpetrol" Z. Genti Gazheli në praninë edhe të Zv. ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Z. Ilir Bejtja.

Takimi u zhvillua në vijim të dialogut dhe diskutimeve punëdhënës-punëmarrës sa i përket çështjeve që lidhen me ristrukturimin e kompanisë të nisur prej vitesh si dhe çështjen e pagave të punonjësve të kompanisë e ngritur për diskutim ditët e fundit. Përfaqësuesit e sindikatës në emër të saj, paraqiten alternativat dhe kërkesat e sindikatës për adresimin e çështjes së pagave, ndërprerjen e shkurtimit të vendeve të punës dhe orientimin e kompanisë drejt konsolidimit si kompani publike. Sindikata vlerësoi ripozicionimin e qeverisë shqiptare për fuqizimin e pozicionit të kompanisë "Albpetrol" si një kompani publike duke qenë se diçka e tillë do t'i shërbente konsolidimit të sektorit të nxjerrjes dhe atij të përpunimit të naftës në Shqipëri dhe rritjes së punësimit dhe standardeve të punës për punonjësit. Në këtë takim, u ra dakort që të mos cenoheshin pagat e ulta të administratës bashkë me pagat e naftëtarëve që u ra dakord të mos prekeshin. Për mundësinë e ristrukturimit të pagave të drejtuesve të lartë të kompanisë dhe çështje të tjera, diskutimet mes palëve mbetën të hapura.

**Në Prill 2020, në kuadrin e advokimit në mbrojtje të interesave të grupeve të ndryshme të punonjësve, CLR ka publikuar qëndrimin e saj** në lidhje me ndërhyrjen që duhet të bëjë Qeveria për kategorinë e punonjësve në sektorin fason të cilëve iu është pezulluar puna por nuk janë çregjistruar nga sigurimet shoqërore si punëmarrës/e deri në 10 ditëshin e parë të muajit prill. Kjo kategori punonjësish nuk arriti të marrë pagën për shkak se puna ka qenë e pezulluar dhe nuk kanë përfituar as pagesën prej 40 000 lekësh nga mbështetja e zgjeruar financiare e qeverisë.

Në vijimësinë e qëndrimit konsekuent për mbrojtjen e të drejtave në punë, **CLR** ka reaguar në lidhje me atë çfarë filloi të ndodhë në kompani të mëdha, në sektorë të ndryshëm privatë të ekonomisë si call center, shërbime, media, etj, ku pas reduktimit të fuqisë punëtore në maksimum, referuar situatës së krijuar nga Covid19, punëdhënësit filluan t’iu kërkojnë punonjësve ende në marrëdhënie pune, përgjysmimin e pagës së tyre duke e përafëruar atë në kufijtë e pagës minimale. CLR konsideroi se një praktikë e tillë përveç se nuk është e drejtë, është edhe e kundërligjshme nëse nuk gjen dakordësinë edhe të punëmarrësve. Në këtë reagim publik përveç denoncimit dhe kritikimit të këtyre formave të menaxhimit të burimeve njerëzore, CLR iu bëri thirrje cilitdo punonjësi që gjendet në një situatë të tillë ta referojë rastin pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës ose CLR për të kërkuar hetim administrativ për çdo kompani të denoncuar duke ruajtur anonimatën e denoncuesit.

**Në Maj 2020, CLR** reagoi përsëri publikisht në mbrojtje të interesave dhe veprimeve të naftëtarëve të Ballshit dhe sindikatës që i përfaqëson ata. Ky grup punonjësish ende pa u shfaqur pandemia përballëshin me një krizë për shkak të mospagimit të 24 pagave të prapambetura. Situata që pasoi me COVID-19 e përkeqësoi edhe më gjendjen e tyre, me largime nga puna dhe reduktim pagash nga ana e Albpetrol. Problemet që vetëm po shtoheshin, i detyruan 900 naftëtarë të dalin në protestë me shpresë se do merrnin atë që u takonte. Në fillim të Shtatorit 2020, CLR përgatiti disa alternativa për zgjidhjen e çështjeve të naftëtarëve të Ballshit. Edison Hoxha, eksperti ligjor i CLR, që ka ndjekur procesin që në fillimet e veta, në një komunikim mediatik për këtë gjë, shpjegoi se qeveria duhet të ndërhyjë për të gjetur një zgjidhje me kompaninë. Ai propozoi këtë skemë: *“Shteti të krijojë një kompani shtetërore dhe ajo të negociojë me pronarët e rafinerisë me qëllim marrjen në përdorim të rafinerisë për qëllim të mbajtjes së punonjësve në punë. Të shikohet mundësia edhe e disa lehtësive fiskale për këtë kompani”*. Në rast se situata nuk do të zgjidhet, atëherë edhe teknologjia e rafinerisë do të vijë duke u amortizuar nga mungesa e investimeve. Ndërkohë që pasojat e papunësisë së naftëtarëve do t’i vuajnë pjesa më e madhe e familjeve në zonën e Ballshit ku rafineria është punëdhënësi më i madh. Më herët, një pjesë e naftëtarëve të Ballshit kishin fituar gjyqet me kompaninë për pagat e prapambetura, por këto vendime nuk janë ekzekutuar dhe ata ende nuk i kanë marrë paratë e tyre. Kjo edhe për faktin se nuk është sqaruar ende ligjërisht se kush i ka këto detyrime pas shitjes disa herë të rafinerisë.

**Në Maj 2020, CLR** ka ngritur shqetësimin për raportimet e dhjetëra pushimeve kolektive nga puna në sektorët privatë të ekonomisë ndërkohë që nuk raportohet respektimi i procedurave ligjore për largimet kolektive nga puna në këto raste. Mungesa e organizimit kolektiv të punonjësve në sektorët e prekur është arsyeja kryesore pse këto procedura nuk respektohen. CLR iu ka bërë thirrje të gjithë punonjësve të prekur nga largimet individuale dhe kolektive të punës të denoncojnë rastin e tyre pranë qendrës, e cila ofron konsulencë ligjore falas që minimalisht secili prej tyre të përfitojë atë që i takon sipas ligjit.



**Në Qershor 2020**, miratohet së fundi Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr.447 dhe Nr. 448 ku janë ripërcaktuar lista e profesioneve dhe e punëve të personelit inxhiniero-teknik që ka punuar në ndërmarrjet e sistemit të naftës. SRNSH ka dhënë për këtë qëllim kontributin e saj të veçantë me propozime konkrete, ku një pjesë e mirë e tyre janë marrë në konsideratë nga Ministria në përgatitjen e VKM-s. SRNSH shprehet se përgjithësisht lista është e plotë dhe e drejtë dhe jep një panoramë të qartë të profesioneve të naftës. Përfshirja e plotë e disa reparteve dhe stafit inxhinierik është për t'u përshëndetur dhe vlerësuar.

**Në fillim të Qershorit 2020**, BSPSH në bashkëpunim me Solidarity Center (AFL-CIO - Sindikatat Amerikane ) lançoi fushatën për ratifikim nga qeveria shqiptare të konventes së ILO-s C190 " Eleminimi i dhunës dhe ngacmimeve në Botën e Punës ". BSPSH në kuadër të një vjetorit të aprovimit të kësaj konvente nga Konferenca e Gjenevës, në Qershor 2019 i bëri përsëri apel qeverisë shqiptare të respektojë votën e saj dhe të ratifikojë sa më shpejt C190. Apel të veçantë, BSPSH iu drejtoi grave deputete në Parlamentin Shqiptar për të përshpejtuar procesin e ratifikimit të konventës së ILO-s C 190, në mënyrë që të gjithë së bashku ti themi "JO Dhunës me bazë Gjinore në Botën e Punës". Deri më tani janë pesë shtete të cilat e kanë ratifikuar këtë konventë: Uruguaj, Ishujt Fixhi, Argjentina, Namibia dhe Somalia. Italia është në proces të shqyrtimit të saj në Parlamentin Italian.

*“Ju bëjmë apel grave deputete të mos votojnë vetëm ligje për reformat zgjedhore, por të votojnë edhe ligje sociale, ligje të botës së punës, një ndër të cilët dhe që do të ndikonte ndjeshëm në parandalimin e çdo lloj forme dhune në punë, është edhe C190 e Organizatës Ndërkombëtare të Punës”,* shprehej në përfundim të deklaratës publike BSPSH. *“Punëtorët duhet të jenë të sigurt në punë, njësoj si në familjet dhe shtëpitë e tyre!”* *“Mos qëndro indiferent: Denonco rastet e dhunës në punë dhe në familje!”* ishin disa prej sloganeve të përdorur nga BSPSH gjatë kësaj fushate.

CLR është duke dhënë një kontribut të shtuar në vazhden e përpjekjeve të sindikatave dhe grupimeve progresiste të punës në vend për sa i takon problematikës së dhunës dhe ngacmimeve në vendin e punës. Me mbështetjen e Olof Palme International Center dhe me fonde të qeverisë suedeze, CLR po zbaton që prej korrikut 2020 projektin **“Stop dhunës dhe ngacmimeve në vendin e punës”**. CLR përmes këtij projekti, synon që të ndërmarrë një studim bazë me shtrirje të gjerë për të:

- kuptuar sa i përhapur, i njohur dhe i adresuar është fenomeni në të dyja sferat e ekonomisë, atë shtetërore dhe private, me qëllim përfitim të një pasqyre të qartë të nivelit të ndërgjegjesimit dhe mënyrës së menaxhimit të rasteve në vendin e punës.
- eksploruar dhe identifikuar format më të përhapura të dhunës dhe ngacmimeve në botën shqiptare të punës, sektorët më të prekur, ndryshimet mes sektorëve në mënyrën si i shfaqin këto fenomene, si dhe faktorët e riskut për secilin sektor, me qëllim që të ndërtohet një bazë fillestare të dhënash për monitorimin e progresit në krijimin e mjediseve të punës të lira nga dhuna dhe ngacmimet.

**Në Korrik 2020**, Sindikata e Re e Naftëtarëve të Shqipërisë (SRNSH) mbrojti punonjësit e administratës së Albpetrol për marrjen e pagës së plotë në pritje të zbatimit të vendimit të KM për mbulimin e përkohshëm të pjeës së munguar të pagave nëpërmjet overdraftit. Rreth 150 punonjës të Albpetrol protestuan kundër vendimit për t'u paguar me 40% të pagës. Për shkak të këtij vendimi nga bordi i kompanisë, i argumentuar prej tyre si pasojë e mungesës së shitjes,

që prej nisjes së pandemisë, punonjësve iu shkurtuan rrogat, duke shkaktuar reagimin e menjëhershëm të tyre.

**Në Shtator 2020**, prezantohet studimi **“Tregues të kontraktimit kolektiv në Shqipëri”**, në fillim të sezonit të vjeshtës një raport i parë i këtij lloji i përgatitur nga Qendra për të Drejtat në Punë, CLR.AL, me qëllim monitorimim e përmbajtjes të kontraktave kolektive në vend. Ky është një studim me vlerë sepse synon të hedhë dritë mbi përmbajtjen reale të kontratave kolektive në Shqipëri, të cilat përgjithësisht janë riprodhim identik i dispozitave ligjore të Kodit të Punës dhe për këtë arsye nuk sigurojnë asnjë mbrojtje esenciale shitesë për punonjësit e mbuluar. Në studim, marrëveshjet kolektive konsiderohen proces dhe jo pikëmbërritje. Vetëm përmes proceseve të plota dhe funksionale të kontraktimit kolektiv, mund të arrihet potenciali i plotë për ndërtimin e organizatave të forta sindikale dhe punëtorëve të fortë. Kontrata kolektive është një ndër instrumentat kryesorë strategjikë që rregullon marrëdhënien e punës. Kontrata kolektive është një rregullator i fuqishëm ligjor sepse sanksionon favorizimin e punëmarrësve në marrëdhëniet e punës. Këtë forcë të madhe ligjore iu del për detyrë aktorëve të fushës ta zhvillojnë dhe zbatojnë në praktikë.

**Më 23 Shtator**, Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, SPSHSH, paralajmëroi për një protestë në oborrin e “Qendrës Spitalore Universitare Nënë Tereza”. Qëllimi i protestës ishte rritja e pagave dhe garantimi i kushteve të sigurisë dhe shëndetit për punonjësit shëndetësorë në luftën kundër koronavirusit. Sindikata kërkoi leje në polici për të vijuar protestën, leje që iu refuzua prej policisë me argumentimin se grumbullimet në kohë Covid-i janë të ndaluara. Darkën e së njëjtës ditë, krerë drejtues të sindikatës njoftuan në media se me vendim të kryesisë së SPSHSH protesta do të zhvillohej por në formë të heshtur. CLR mbështeti fuqimisht tubimin paqësor të Sindikatës së Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor në mjediset e QSUT. Njëkohësisht, një grup përfaqësues i sindikatës është thirrur për bisedime pranë Kryeministrit, në praninë edhe të përfaqësuesve të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

**Më 18 Nëntor**, CLR i bashkohet nismave të Rrjetit global #CleanClothesCampaign përgjatë Javës së Veprimit Global #PayYourEorkers (#PaguajPunëtorëteTu). Gjatë kësaj jave CLR së bashku dhe me organizatat e tjera shqiptare anëtare të rrjetit ushtruan presionin sindikalist të nevojshëm mbi kompanitë e veshjeve në mënyrë që kompanitë të mbajnë përgjegjësi për pagat e papaguara të punëtorëve në zinxhirët e tyre të prodhimit. Veprimet në dhjetëra vende në të gjithë botën do të amplifikojnë zërat e punëtorëve, pagat e të cilëve u prenë ose vendet e punës u mbyllën pa kompensim gjatë pandemisë. Punëtorët, sindikalistët dhe advokuesit e të drejtave në punë po u bëjnë presion markave dhe shitësve me pakicë të sigurojnë publikisht që punëtorët që kanë prodhuar mallrat e tyre para pandemisë, të paguhen me rrogat e tyre të plota ose të marrin shpërblimin e shkëputjes që u takon. Që nga fillimi i pandemisë, miliona punëtorëve të industrisë së tekstileve nuk u janë paguar rrogat e tyre të plota ose janë pushuar nga puna pa kompensimin e duhur. Hulumtimi nga Clean Clothes Campaign, botuar në gusht 2020, tregoi se vetëm për tre muajt e parë të pandemisë, kompanitë iu detyrohen punëtorëve 3.2 deri në 5.8 miliardë dollarë paga të papaguara dhe kompensime të ligjshme. Që prej qershorit 2020, Clean Clothes Campaign u ka bërë thirrje markave dhe shitësve me pakicë që të angazhohen që të përmbushin këtë boshllëk me çdo mënyrë dhe të sigurojnë që punëtorët të cilët përpara pandemisë paguheshin me paga minimale në kufirin e varfërisë, të mos paguajnë çmimin për këtë krizë. Mbi një duzinë markash më të vogla tashmë i janë përgjigjur pozitivisht thirrjes së Clean Clothes Campaign #PayYourEorkers<sup>13</sup>. Tani është koha që të tjerët të ndjekin

<sup>13</sup> [www.cleanclothes.org/payyourworkers](http://www.cleanclothes.org/payyourworkers)

shembullin, veçanërisht kompanitë e mëdha që kanë ndikimin më të madh, të tilla si H&M, Nike dhe Primark. Në disa dhjetëra vendndodhje nëpër botë, punëtorët, sindikalistët dhe aktivistët e tjerë mes tyre edhe CLR në Shqipëri, u bënë bashkë për t'i tërhequr vëmendjen për situatën e këtyre miliona punëtorëve të papaguar dhe ushtruan presion mbi kompanitë në krye të zinxhirëve të furnizimit për t'u zotuar që do të sigurojnë pagat e punëtorëve të tyre.

Më **nëntor 2020**, Sindikata e Punonjësve të Shërbimeve Policore kërkoi përmirësimin e kushteve themelore të punës dhe pagesës në institucionet e vuajtjes së dënimit. Sipas kryetarit të Sindikatës së Punonjësve të Shërbimeve Policore, Valentin Maçaj, problemet e punës në sistemin e burgjeve janë të shumta, duke nisur nga trajtimi financiar, kushtet e punës, deri tek uniforma dhe trajtimi ushqimor. *“Kemi probleme me pagat, problem me kushtet në punë, mungon një mjek për stafin, mungojnë uniformat, nuk kemi një shkollë të mirëfilltë për trajnimin e policëve në burgje. Transporti është një tjetër problem”*, u shpreh në vazhdim kryesindikalisti i punonjësve të burgjeve. Plot 224 punonjës të policisë së burgjeve firmosën më pas një peticion drejtuar Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Burgjeve ku paralajmëronin për përshkallëzim të protestës gjer në plotësimin e kërkesave të tyre.

Më **18 Dhjetor**, themelohet ligjërisht Sindikata Kombëtare të Punonjësve të Operatorëve Telefonikë SKOT, sindikata më e re që do të operojë në sektorin Call Center. Falë përpjekjeve kolektive të SKOT, u arrit fitimi i çështjes gjyqësore kundër kompanisë italiane B- Connect për kompesimin financiar të punonjësve për festat zyrtare të papaguara të vitit 2019, sipas përcaktimeve përkatëse të Kodit të Punës në këtë drejtim. Ky kompensim në vlera të konsiderueshme, afërsisht më shumë se 350 mijë lekë të vjetra për çdo njërin nga 380 punonjësit e kompanisë, i ngarkoi kompanisë në fjalë detyrimin për pagimin në total të një shumë prej 130 milionë lekësh për të drejtën e mohuar nga punëdhënësi kundrejt këtij grupi punëmarrësish. Gjykata vendosi gjithashtu, në zbatim të legjislacionit shqiptar të punës, edhe detyrimin e punëdhënësit që kjo pagesë të vazhdojë të paguhet edhe për gjithë periudhën në vazhdim.

### 5.2.3. Siguria dhe Shëndeti në Punë

Në fillim të Janarit 2020, një aksident në punë me pasoja fatale ka ndodhur në qytetin e Korçës. CLR bën thirrje për ndërhyrje të menjëhershme dhe të rakorduara institucionalisht, sa i përket:

1. Rritjes së nivelit të inspektimit në punë.
2. Krijimit dhe bërjes funksionale të këshillave të sigurisë dhe shëndetit në punë në sektorin e ndërtimit.
3. Organizimit të punonjësve në sindikata funksionale për të mbrojtur dhe përfaqësuar të drejtat e tyre në punë.

Në muajin Prill 2020, CLR ka publikuar artikullin në lidhje me Ditën Botërore për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë. Mesatarja vjetore e aksidenteve në punë në Shqipëri luhet midis 150-200 të aksidentuarve. Gjatë 2019, humbën jetën duke punuar 38 punonjës dhe u aksidentuan 176 të tjerë. Të gjitha qarqet e Shqipërisë kanë shënuar të vdekurit e tyre në punë. Mungojnë statistikat për sëmundjet profesionale. Pjesa më e madhe e njerëzve nuk e dinë në ç'mënyrë puna po u dëmton shëndetin. Në këtë ditë të shënuar, CLR bën thirrje për më shumë respektim të dispozitave ligjore për sigurinë dhe shëndetin në punë nga ana e punëdhënësve për të përmbushur detyrimin e tyre për pajisjen e punëmarrësve me mjetet mbrojtëse individuale dhe kolektive. Nga ana tjetër punëmarrësit duhet të ndërgjegjësohen për rëndësinë e pajimeve

mbrojtëse individuale dhe për të denoncuar pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës punëdhënësit të cilët nuk garantojnë vende pune të sigurta dhe të denja. Pavarësisht, mbrojtjes që mund të vijë nga institucionet monitoruese dhe vetë ligji, mbrojtja më e mirë për punëtorët është organizimi kolektiv. Organizimi në sindikata është mënyra më e mirë për të mbrojtur të drejtat në punë.

Si një mbështetëse e fortë e **sigurisë në punë në shërbim të mbrojtjes së jetës**, CLR ka reaguar duke shpërndarë lajmin e publikuar nga SRNSH për një aksident tragjik në punë me pasoja fatale për jetën e një punonjësi, i cili u regjistrua më datë 3 prill 2020, në Qendrën e Prodhimit të Naftës QPN Kuçovë. Aksidenti ka ndodhur gjatë punës për mirëmbajtjen/saldimin e një pusi nafte (vulfi) ku si pasojë ka mbetur i plagosur rëndë punonjësi L.F. 60 vjeç i cili edhe pse është nisur me urgjencë në spital nuk ka mundur t'i mbijetojë plagëve të marra dhe ka ndërruar jetë në spitalin rajonal të Beratit. CLR ringriti shqetësimin se siguria në punë sidomos në industrinë nxjerrëse është e mangët. CLR u vendos në mbështetje të sindikatës dhe të familjes së të ndjerit për të nxjerrë të vërtetën, përgjegjësit dhe gjithçka i takon këtij rasti, si mënyra më e rëndësishme e ndërgjegjësimit për të gjithë punonjësit, që raste të tilla tragjike të mos përsëriten më në të ardhmen.

### 5.2.5. Marrëdhëniet e punës dhe Dialogu social

**Gjatë vitit 2020**, Këshilli Kombëtar i Punës ka zhvilluar dy mbledhje (online) në Qershor dhe Tetor 2020. Sindikatat dhe Punëdhënësit kanë kërkuar të diskutojnë dhe të informohen për situatën e ndodhur për shkak të pandemisë në disa sektorë të ekonomisë në Shqipëri dhe konkretisht:

- *Informim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë mbi masat e marra nga Qeveria për mbështetje financiare për punëdhënësit dhe punëmarrësit gjatë periudhës së shkaktuar nga Covid 19;*
- *Informim nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale mbi masat e marra për mbrojtjen e shëndetit të qytetarëve;*
- *Informim nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë për mbylljen e vitit shkollor dhe masat e marra për të siguruar distancimin fizik mes nxënësve për vitin e ri shkollor;*
- *Informim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit për masat e marra për mbështetjen e sektorit të turizmit;*
- *Raportim mbi veprimtarinë dhe rolin e Agjencisë Kombëtare për Punësim dhe Aftësi;*

Gjatë mbledhjes së KKP të datës 16 Tetor 2020, u trajtuan çështjet e mëposhtme:

- *Situata shëndetësore në vend, masat e marra për të përballuar situatën e COVID-19 dhe mbështetjen financiare për punonjësit e sistemit shëndetësor;*
- *Fillimi i vitit shkollor 2020-2021, masat e marra për të përballuar situatën e COVID-19 dhe mbështetjen financiare për mësuesit;*
- *Rritja e pagës minimale*
- *Situata në sektorin e turizmit dhe propozime nga punëdhënësit për mbështetjen e punonjësve të industrisë duke marrë si model vendet fqinje;*
- *Konkluzionet e studimit për krahasimin e legjislacionit tonë me konventën nr. 190 "Kundër dhunës dhe ngacmimeve në botën e punës" të ILO-s;*
- *Situata lidhur me zbatimin e legjislacionit të punës veçanërisht për kohën e punës dhe pushimit, informuar nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore*

Një sfidë për sindikatat dhe organizatat që merren me çështjet e punës në vend, ka qenë mungesa e kriterëve të paracaktuara, objektive dhe lehtësisht të verifikueshme për përfaqësimin e Partnerëve Socialë në Këshillin Kombëtar të Punës. Çështja e përfaqësueshmërisë së partnerëve socialë u realizua së fundi gjatë 2020m pas shumë takimesh dhe diskutimesh me Partnerët Socialë për më shumë se dy vjet. Në janar të vitit 2020 u miratuan “**Kriteret e përfaqësueshmërisë të Partnerëve Socialë në Këshillin Kombëtar të Punës**” me VKM nr. 54, datë 29.1.2020 nga Këshilli i Ministrave, të cilat do të garantojnë legjitimitetin e KKP-së, ndikimin politik dhe rritjen e besueshmërisë së mendimeve dhe rekomandimeve të këtij Këshilli.

Përfaqësimi i organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve në Këshillin Kombëtar të Punës përcaktohet sipas kriterëve të mëposhtme:

a) *për organizatat e punëmarrësve (konfederata, federata, sindikata):*

- i. *personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi, prej më shumë se 2 (dy) vjetësh;*
- ii. *pavarësi organizative e financiare;*
- iii. *shtrirje territoriale në të paktën 50 (pesëdhjetë) % të qarqeve të vendit, përfshirë dhe qarkun e Tiranës;*
- iv. *strukturë administrative për të përmbushur detyrimet ligjore të partneritetit social;*
- v. *numri i përgjithshëm i anëtarëve në konfederatë të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të përgjithshëm të punëmarrësve në shkallë vendi, por jo më pak se 20 000 (njëzet mijë) anëtarë; ndërsa për federatat dhe sindikatat, numri i përgjithshëm i anëtarëve në shkallë vendi të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të punëmarrësve në degën/profesionin përkatës;*
- vi. *numri i kontratave kolektive, si dhe numri I përgjithshëm i punëmarrësve të mbuluar me kontrata kolektive;*
- vii. *anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të punëmarrësve.*

b) *Për organizatat e punëdhënësve:*

- i. *personalitet juridik, sipas legjislacionit në fuqi, prej më shumë se 2 (dy) vjetësh;*
- ii. *pavarësi organizative e financiare;*
- iii. *shtrirje territoriale në të paktën 50 (pesëdhjetë) % të qarqeve të vendit, përfshirë dhe qarkun e Tiranës;*
- iv. *strukturë administrative për të përmbushur detyrimet ligjore të partneritetit social;*
- v. *numri i anëtarëve që punësojnë të jetë jo më pak se 5 (pesë) % e numrit të punëmarrësve në degën/profesionin përkatës;*
- vi. *numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të anëtarësuar, i cili nuk mund të jetë më i vogël se 10 (dhjetë) % nga numri i përgjithshëm i ndërmarrjeve të regjistruara në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);*
- vii. *anëtarësimi në organizata ndërkombëtare të punëdhënësve”.*

*Me përfundimin e mandatit 3-vjeçar (trevjeçar), sekretariati i Këshillit Kombëtar të Punës mbledh dokumentacionin e organizatave të punëmarrësve dhe të punëdhënësve, që janë të interesuara të jenë pjesë e këtij këshilli, 3 (tre) muaj përpara se të përfundojë mandati.*

*Një organizatë e punëmarrësve apo e punëdhënësve vlerësohet më e përfaqësuar nëse ka numrin më të madh të kontratave kolektive dhe numrin më të madh të anëtarëve, ndërsa një organizatë punëdhënësish vlerësohet nga numri i ndërmarrjeve, numri i punonjësve të punësuar në ndërmarrje dhe numri i degëve/profesioneve.*

## **Konventa 190 “Për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës”.**

MFE ka ndërmarrë iniciativën për ratifikimin e Konventës 190 “Për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës” të ILO-s, në bashkëpunim me Konfederatën Sindikale të Shqipërisë

(KSSH) dhe Bashkimin e Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH). Ratifikimi i kësaj Konvente ka për qëllim pozicionimin e vendit tonë në grupin e vendeve që kontribuojnë në luftën kundër këtij fenomeni shqetësues dhe kërcënues për dinjitetin, shendetin dhe sigurinë në punë dhe

në garantimin e një mjedisi pune të sigurt. Ratifikimi i kësaj konvente është në përputhje me programin e qeverisë shqiptare shprehur qartazi në gjithë instrumentet që gjenden në kuadrin ligjor dhe institucional shqiptar. Ky proces ka avantazhet e veta dhe deri tani vendi ynë ka bërë një përparim të konsiderueshëm. Shumë ligje janë në përputhje me standardet e BE (të tilla si: *Kodi i Punës, Ligji për Barazinë Gjinore, Ligji për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ligji për Sigurinë dhe shendetin në punë, Ligji për Arsimin dhe Formimin Profesional* etj.). Gjithashtu një numër i konsiderueshëm i konventave ndërkombëtare që janë të rëndësishme në kontekstin e analizës së Konventës së 190 të ILO janë ratifikuar tashmë, kjo e bën edhe më të lehtë përqasjen me këtë konventë. Projektligji për ratifikimin e Konventës 190 është dërguar për mendim në Ministrinë e Drejtësisë dhe Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme e cila kërkoi të bëhëj një studim nëse legjislacioni i brendshëm vendas është në përputhje me parashikimet e Konventës. Për këtë arsye meqenëse Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk kishte kapacitetet e duhura për ta bërë këtë studim, iu drejtuan Zyrës Ndërkombëtare të Punës (ILO) e cila kontraktoi një eksperte të fushës për të bërë një analizë më të detajuar të legjislacionit shqiptar mbi dhunën dhe ngacmimin në punë për përputhmërinë me Konventën 190. Nga analiza rezultoi se legjislacioni ynë plotëson kërkesat minimale të konventës gjë që na mundëson vazhdimin e procedurës duke programuar përmirësimin e legjislacionit në vijimësi sa herë bëhen ndryshimet në legjislacion dhe trajnuar strukturat në dispozicion. Zbatimi i kësaj konvente nuk kushtëzohet nga dalja e menjëhershme e ligjeve sepse nuk janë ligje të reja dhe nuk kërkohen struktura të reja. Gjithsesi nevojiten saktësime procedurale dhe përcaktim të qarta detyrash në të ardhmen. Konventa nr. 190 e ILO-s “Për eliminimin e dhunës dhe ngacmimit në botën e punës” u miratua në parim nga përfaqësuesit e Punëdhënësve dhe Sindikatat në mbledhjen e datës 12 qershor 2020 të Këshillit Kombëtar të Punës (KKP) dhe më pas u miratua në parim edhe analiza e legjislacionit

shqiptar mbi dhunën dhe ngacmimin në punë kundrejt përputhshmërisë me Konventën 190 të ILO në mbledhjen e KKP të datës 16 tetor 2020. Së fundi, Këshilli i Ministrave ka kërkuar të ridërgohet edhe njëherë projektligji për mendim te Ministria e Drejtësisë dhe Ministria e Jashtme për rivlerësim të termit “ratifikim” apo “pranim” të Konventës 190.

### **Kronologji e funksionimit të Dialogut Social**

#### **– Shembull sukcesi i punonjësve të ish – ARMO-s dhe Sindikatës së Naftëtarëve të Ballshit në drejtimin e tyre**

- ✚ Më 8 nëntor, fillon dialogu për çështjen e punonjësve të rafinerisë së ish- ARMO, Ballsh mes përfaqësuesve të grevistëve dhe qeverisë. Pas shumë ditësh grevë urie e sakrificave vetëmohuese të grave naftëtare, qeveria jep shenja pozitive për zgjidhjen me dialog të çështjes së këtyre punonjësve. CLR në një deklaratë publike në rrjetet sociale, përshëndeti fillimin e dialogut ndërmjet palëve si rruga e vetme për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme në situatën komplekse të krijuar.

- ✚ **Më 9 nëntor**, naftëtarët dhe sindikata e tyre detyrojnë Kryeministrin e Shqipërisë të shkojë në qytetin e tyre dhe të ulet vetë personalisht në dialog me punonjësit. Pjesë e përfaqësisë që u takua me kryeministrin, janë disa prej grave greviste, punonjës të Rafinerisë, si dhe kreu i sindikatës së naftëtarëve, Sokol Dautaj. Takimi mes palëve zgjati për më shumë se 2 orë për të trajtuar kërkesat që kanë lidhje me punën e tyre të papaguar dhe vazhdimësinë e saj dhe përfundon me marrëveshje. Kryeministri Edi Rama iu premton një pagë të papërcaktuar deri në rifillimin e punës, pa marrë përsipër megjithatë që të zgjidhë problemin e pagave të prapambetura.
- ✚ **Në po këtë ditë**, kreu i sindikatës së naftëtarëve të Ballshit, Sokol Dautaj deklaroi për BIRN se gjatë takimit me kryeministrin Edi Rama, naftëtarët u kishin qëndruar të gjitha kërkesave të tyre, përfshi rifillimin e punës dhe shlyerjen e pagesave të prapambetura. *“Dakordësia e arritur nuk është e kënaqshme, por të detyruar nga situata e vështirë ekonomike, e pranuar. Për pagat e prapambetura do ta ndjekim çështjen deri në Strasburg,”* tha kreu i sindikatës, Dautaj. Pas privatizimit të dështuar të vitit 2008 dhe ndërrimit të disa duarve, rafineria e Ballshit u mor në administrim në mars të vitit 2018 nga kompanitë Tosk Energji dhe Bylis Energji, të cilat janë në pronësi të dy kompanive zvicerane, CFD Conseils Srl dhe PGFS Pilotage & Gestion S. Së fundmi, KPTHN e Ballshit administrohet nga kompania Allum Enterprises, e cila edhe pse negocioi me naftëtarët pas protestave të tyre, nuk dha ndonjë zgjidhje konkrete për rifillimin e punës dhe pagesën e rrogave të prapambetura. *“Nuk është përcaktuar ende se sa do të jetë vlera, por u diskutua se mund të jetë midis pagës minimale dhe rrogës sonë. Presim të ulemi sërish brenda 48 orëve për të vendosur për vlerën e pagës që do të merret deri në rifillimin e punës,”* tha Dautaj po për BIRN. Ai tha se në takim kishin këmbëngulur që shteti të ofronte garanci për naftëtarët në të ardhmen, ndërsa kryeministri Rama ishte përgjigjur se po negociohej me kompani serioze, por pa dhënë detaje konkrete.
- ✚ **Në 13 nëntor**, kreu i Sindikatës së Naftëtarëve Sokol Dautaj pas përfundimit të takimit me kryeministrin Edi Rama deklaroi se kanë arritur dakordësinë që të marrin 400 mijë lekë të vjetra për një periudhë 12 mujore, si dhe sigurimet shoqërore. Dautaj tha se nga kjo pagë do të përfitojnë 870 naftëtarë, duke shtuar se do të përfitojnë të gjithë naftëtarët të cilët kanë qenë në listën e borderosë duke filluar nga dhjetori i vitit 2019. *“Kemi arritur dakordësinë që të jepet një pagë prej 400 mijë lekësh prej një periudhë 12 mujore si dhe sigurimeve të pagave që do të marrim. Me zgjidhjen e dytë jemi të kënaqur, por me detyrimet e prapambetura që kemi në kohë, duhet të ndiqet rruga ligjore. Në kërkim një kompromis që duke parë hallet tona pagat të merren dy dhe nga dy. U hodh ideja që po punohet me kompaninë, ne jemi skeptik deri në ardhjen e kompanisë”*, vazhdon deklarimet e tij për median kryesindikalisti.
- ✚ **Në po të njëjtën ditë**, Komisioni i Ekonomisë akordon 560 milionë lekë për naftëtarët.

## 5.2.6. Situata pandemike Covid 19 dhe reagimet e aktorëve të botës së punës

**Më 10 Mars**, vetëm një ditë pas shpalljes së pranisë së Covid-19 në Shqipëri, CLR ka filluar monitorimin hap pas hapi mbi zhvillimet e fundit në vend lidhur me situatën e jashtëzakonshme të rrezikut të shëndetit publik pas evidentimit të rasteve të para me virusin Covid-19 në vendin tonë.

Në këtë kuadër pas shqetësimit të përcjellë nga SKOT, sindikata partnere në sektorin Call Center, së bashku i janë drejtuar Inspektoriatit të Punës me një kërkesë për ndërhyrje të menjëhershme sa i përket kërkesave të mëposhtme:

1. *Cilat janë distancat që duhet të kenë punëtorët nga njëri-tjetri?*

2. Cilat janë masat e shtuara higjieno-sanitare që duhet të ndërmarrin kompanitë?
3. Cilat janë masat dhe lëshimet që duhet të përfitojnë punëtorët në këtë periudhë të vështirë? (Për shembull nënat me femijë).
4. Cila është dendësia për metër katrorë e lejuar për popullimin e mjediseve të punës
5. Nisur nga vendimi i fundit i Këshillit të Ministrave “Për caktimin e datave 10 deri në 23 mars 2020 ditë pushimi për prindin kujdestar të fëmijëve të mitur”, a mund ta përfitojnë këtë të drejtë automatikisht edhe punonjësit e call center dhe a është e pagueshme kjo periudhë për sektorin call center?

SKOT dhe CLR së bashku i bënë thirrje të gjithë organizatave ose punonjësve që ndihen se ndaj tyre nuk janë ndërmarrë të gjitha hapat e nevojshme për t’iu garantuar atyre masat mbrojtëse paraprake nga Covid-19, të drejtohen pranë të dyja organizatave në çdo kohë dhe rast.

**Po në vijim të përcjelljes së shqetësimeve të sindikalistëve dhe grupeve të ndryshme të punëmarrësve në sektorë të ndryshëm të ekonomisë, në kuadër të masave parandaluese të ndërmarrura nga qeveria Shqiptare në përballim të emergjencës shëndetësore prej Covid-19.** CLR iu drejtua Kryeministrit të Shqipërisë dhe ministrave përkatës për t’iu sjellë në vëmendje domosdoshmërinë e ndërmarrjes së masave shtesë të posaçme parandaluese mbrojtëse për personat që janë aktualisht në marrëdhënie pune dhe vuajnë nga sëmundje kronike apo autoimune duke kërkuar trajtimin e tyre në mënyrë analoge me rastin e prindit kujdestar të fëmijëve të mitur, të cilëve sipas VKM-së përkatëse iu është garantuar pushim nga data 10-23 Mars 2020, (ose në një mënyrë tjetër të përshtatshme që do garantonte mbrojtje të shtuar për këto kategori punonjësish). Në kërkesën zyrtare drejtuar institucioneve të linjës, CLR argumentonte se ky grupim pacientësh ka 5 herë më shumë gjasa që të ketë pasojë fatale në rast infektimi, pavarësisht nga moshë apo gjendja e mëparshme shëndetësore.

Në dialogun e vazhdueshëm me punonjësit e shqetësuar nga situata e paprecedentë, si dhe në përgjigje të pyetjeve të shumta ku një pjesë e tyre kërkon informacion nga CLR lidhur me faktin që Vendim në fjalë i Këshillit të Ministrave, ka apo jo efekt detyrues edhe në sektorin privat, CLR ka sqaruar publikisht si më poshtë:

*“Ky vendim ka vetëm fuqi orientuese dhe sugjeruese për sektorin privat dhe jo detyruese, përveçse nëse kjo gjë është parashikuar nga kontrata juaj kolektive ose nga kontrata individuale e punës së secilit. Në rast se nuk përmbushen asnjë nga rastet e mësipërme, atëherë sindikata që përfaqëson interesat tuaja duhet ta negociojë këtë gjë me punëdhënësin. Nëse nuk keni sindikatë që ju përfaqëson atëherë, zbatimi i këtij vendimi ngelet në dorën e punëdhënësit tuaj.*

*Gjithsesi, edhe në këtë rast nëse arrini të krijoni një grup jo të formalizuar brenda punëmarrësve në kompaninë tuaj, CLR mund t’ju asistojë të kërkonti që kjo VKM të zbatohet edhe në kompaninë tuaj.”*

Dy ditë më vonë, **më 12 Mars** CLR i kërkoi zyrtarisht qeverisë shqiptare dhe gjithë instancave shtetërore kompetente, të kërkojnë pezullimin e menjëhershëm të punës në sektorët "call center" dhe "fasoneri" në të gjithë Shqipërinë për periudhën deri më 23 mars. Në këta sektorë shërbimesh janë të punësuar rreth 100 000 punonjës. Në kërkesën drejtuar instancave qeveritare, CLR bëri njëkohësisht thirrje që duke u dakordësuar me punëdhënësit përkatës, të marret përsipër, nëse është e nevojshme, edhe pagesa e punonjësve me pagë minimale për sa kohë vazhdon ndërprerja e punës. CLR argumentoi që nuk ka nevojë për vendim të posaçëm pasi kjo masë mund të vijë në kuadër të vendimarrjes së qeverisë sa i përket ndalimit të



grumbullimeve të çdo lloji. Puna në këta sektorë shërbimesh është një grumbullim i pastër dhe që nuk garanton sigurinë dhe mbrojtjen minimale të punonjësve nga Covid-19.

**Më 13 Mars,** CLR publikoi qëndrimin e saj lidhur me vendimin e qeverisë për ndërprerjen e punës në sektorët e “call center” dhe “fasoneri”:

*“Me ndërprerjen e punës në fasoneri dhe call center, vendim i cili hyri në fuqi sot, adresohet pjesërisht një nga kërkesat dhe shqetësimet e CLR. Ndërkohë që me ndërprerjen e punës për gjithë punonjësit e administratës publike, është adresuar plotësisht shqetësimi ynë sa i përket kërkesës që ka të bëjë me kategorinë e punonjësve publikë me probleme kronike shëndetësore. Tashmë të gjithë bashkë për të mbështetur dhe garantuar sigurinë dhe të drejtat e punonjesve të sistemit shëndetësor, heronjve të ditës, atyre që janë në vijën e parë të rrezikut në situatën e krijuar.”*

Në vijim të mbajtjes gjallë të shqetësimit dhe ndërgjegjësimit mbi risqet nga puna në grup, SKOT bën një deklaratë publike lidhur me situatën e punës në sektorin e call center për shkak të epidemisë së COVID-19. SKOT duke ndjekur në mënyrë të vazhdueshme udhëzimet e qeverisë dhe duke qenë në mënyrë të vazhdueshme në kontakt me Inspektoriatin e Punës dhe Shërbimet Shoqërore dhe organet e tjera shtetëore, si dhe me punëdhënësit dhe përfaqësues të tyre nëpër Call Center-a ku sindikata ka të përfaqësuarit e vet, u vërejt se:

- *Masat e vendosura nga Qeveria janë absolutisht minimale përsa i përket Call Center-ave (është e kotë të bësh një dezinfektim e pastaj të mbledhësh 200 veta në një sallë)*
- *Mungon mjeku i kompanisë nëpër vendet e punës si dhe çfarëdolloj mase mbrojtëse (maska dhe doreza e dezinfektantë në mënyrë të mjaftueshme)*
- *Mungon ajrimi i vazhdueshëm dhe konstant;*
- *Nuk zbatohet nga punëdhënësit dhe administrata e Call-Center-ave ajo që quhet "Smart-Working", pra puna nga shtëpia, nëpërmjet kompjuterit megjithëse është diçka krejtësisht në dorë të tyre dhe plotësisht e realizueshme brenda një afati shumë të shkurtër;*
- *Nuk është marrë asnjë masë për transportin e punonjësve në këtë gjendje shtetrrrethimi dhe punonjësit detyrohen të bëjnë me kilometra në këmbë për t'u paraqitur në punë pasi përballen me frikën e pushimit nga puna në mënyrë të padrejtë.*

SKOT kërkoi nga qeveria në mënyrë urgjente nxjerrjen e një pakete masash sociale për sektorin e call Center-ave. Ajo duhet të detyrojë kompanitë të zbatojnë "SmartWorking", pra punën nga shtëpia për punonjësit e tyre e atje ku nuk është e mundur të paguajnë punonjësit që detyrohen të rrinë në shtëpi.

*“Është e kotë të mbyllim bar-kafet, restorantet e tubimet publike kur nëpër call center-a kemi grumbullime deri në 300-400 veta për çdo sallë”,* u shpreh në kërkesën e saj Sindikata.

Si pasojë e presionit dhe advokimit të suksesshëm, kompanitë "call center" morën gradualisht përsipër zvogëlimin drastik të numrit të punonjësve dhe në mënyrë graduale, transferimin e kryerjes së punës nga shtëpia dhe shumë kompani tashmë e kanë realizuar me sukses këtë proces.

**Në 17 Mars,** Sindikata e Shërbimeve Policore të Shqipërisë drejtoi një apel publik ndaj Qeverisë Shqiptare:

*“Masat e marra nga qeveria janë të domosdoshme për të mbrojtur jetën e qytetarëve shqiptarë, ndaj duhen mirëpritur nga të gjithë. Rregulli e disiplina janë sfida kryesore në përballimin e kësaj gjendjeje. Por, krahas stafit mjekësor, duhet të evidentohen edhe mijëra punonjës të*

*Shërbimeve Policore në rend e institucionet e vuajtjes së dënimit, si dhe zjarrëfikësit në 61 bashkitë e vendit. Policia e Shtetit ka infrastrukturë e mjete më të përshtatshme për kryerjen e detyrës në komisaritet respektive, po ashtu edhe Shërbimi Zjarrfikës, i cili është i dislokuar në pikat e afërta me qendrat e bashkive, ndërsa shërbimi policor më në vështirësi në këto momente vendimtare është policia e burgjeve, e cila shërben në 24 institucione penitenciare të shpërndara në cdo cep të Republikës së Shqipërisë. Policia e Burgjeve, e cila vazhdon të jetë e diskriminuar në pagë, pa mjaftueshmëri në mjete logjistike e kushte pune, me mungesë transporti për në vendin e punës, pa vakt ushqimor gjatë turnit të shërbimit, si dhe nën stres e trysni përballë krimit të organizuar, vazhdon të përballojë me sukses dinamikën e punës në çdo sektor shërbimi. Duhet thënë se Ministria e Drejtësisë dhe Drejtoria e Burgjeve, me ato pak burime financiare e njerëzore, kanë vënë në zbatim një plan masash të lavdërueshëm, ku objektiv kryesor është mbrojtja e jetës së stafit dhe shtetasve të dënuar e paraburgosur. Stafit drejtues e zbatues po përballojnë me sukses situatën emergjente, por nuk ka mjaftueshmëri financiare në motivimin e punonjësve, pasi janë rritur shpenzimet personale të punonjësve në transport dhe ushqim, të cilat duhen garantuar nga punëdhënësi shtet. Nisur nga kjo dhe për të qenë sa më bashkëpunues në mirëfunksionimin e shërbimit të sigurisë në burgje, Sindikata kërkon nga qeveria shqiptare dhënie të një fondi emergjent në zërin e pagave për një shpërblim mujor deri 15.000 lekë të rinj për punonjësit e policisë dhe stafin civil në burgje, duke garantuar se motivimi për ta, do të ishte në lartësinë e duhur. Nëse stafit mjekësor që po përballon direkt me situatën, i është premtuar nga Qeveria deri në 1000 euro shtesë në pagën mujore, Sindikata i kërkon 10 herë më pak, pra vetëm 15000 lekë shtesë në pagën mujore në stafin e burgjeve, shumë kjo, e cila mbulon ato shpenzime që ligjërisht i takon shtetit t'i sigurojë. Respekti për shërbimet e sigurisë jetike, është sukses i garantuar në zbatimin e ligjit në çdo lloj situatë të vështirë”*

**Po ashtu** një reagim publik me vlerë ka qenë ai i "Sindikates se Re të Naftëtarëve Shqiptarë" , SRNSH në lidhje me situatën të cilën po kalon vendi për shkak të COVID-19:

*“SRNSH është duke ndjekur me vëmendje dhe nga afër situatën e krijuar për shkak të epidemisë Covid-19 në vendin tonë. Ne jemi duke ndjekur në mënyrë të vazhdueshme udhëzimet e qeverisë dhe institucioneve të tjera në lidhje me situatën dhe jemi në mënyrë të vazhdueshme në kontakte me Inspektoriatin e Punës, organet e tjera shtetërore dhe punëdhënësit përkatës. Në funksion të informimit dhe mbarëvajtjes së punës dhe të mbrojtjes sa më të mirë të punonjësve të naftës dhe gazit, Sindikata është përqendruar sidomos në zbatimin siç duhet të Urdhërit të Inspektoriatit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, datë 12.03.2020 "Për marrjen e masave të veçanta për parandalimin e përhapjes së Covid-1 e sidomos sa i përket ndjekjes së punës për dezinfektimin e ambjenteve të punës individuale dhe të përbashkëta. Për qendrat e prodhimit të naftës të cilat kanë vazhduar punën për shkak të mosndërprerjes së prodhimit të naftës, në bashkëpunim me punëdhënësin jemi duke ndjekur masat që duhet të ndërmerren për të siguruar transportin e punonjësve në gjendjen e shtetrrëthimit ku ndodhemi dhe faktin që punonjësit e prodhimit duhet të bëjnë kilometra të tëra rrugë për t'u paraqitur në punë dhe garantimi i transportit në këtë kohë është një masë minimale për mbrojtjen e tyre nga covid-19. Masat e nevojshme mbrojtëse individuale për çdo punonjës si maska, doreza të përshtatshme në mënyrë të mjaftueshme dhe të vazhdueshme deri në përfundim të kësaj gjendjeje. Ndërkohë, Sindikata ka marrë të gjitha masat për të ndërgjegjësuar çdo punonjës për të respektuar me rigorozitet masat e ndërmarra me qëllim shmangien e çdo pasoje të mundshme në të mirë të secilit dhe të të gjithëve”.*

**CLR në përmbushje të detyrimit për informimin e vërtetë të punonjësve shqiptarë, ka bërë gjithashtu publik rastin e konfirmimit të rastit të parë të infektimit me Covid-19 të një**

punonjësi në sektorin call center dhe një punonjëseje të sektorit fason. CLR kërkoi edhe njëherë me këtë rast pezullimin e plotë të përkohshëm të punës në këtë sektor, duke garantuar njëkohësisht për punonjësit pagesën në vlerën e pagës minimale dhe lehtësi fiskale për kompanitë fason gjatë kësaj periudhe. CLR u shpreh në këtë drejtim se është e pamundur të garantohet në mënyrë të vazhdueshme siguria e punonjësve në këtë sektor, vetëm duke kërkuar zbatimin e masave të largësisë së punonjësve nga njëri-tjetri dhe atyre higjeno-sanitare.

**Më 21 Mars,** CLR vijoi komunikimin publik lidhur me ndjekjen dhe mbarëvajtjen e punës në sektorë të ndryshëm të prodhimit në të cilët puna vazhdon. Në sektorin e naftës dhe në disa sektorë të përpunimit industrial mbetet problem për adresim transporti i punonjësve. Bazuar në rregullat e vendosura nuk është e mundur që punonjësit të udhëtojnë për në vendet e tyre të punës me makinat e tyre personale por duhet të udhëtojnë të gjithë me transport të përbashkët i cili nuk garanton largësinë e duhur të punonjësve nga njëri-tjetri brenda automjetit (autobuz/fugon) për t'i mbrojtur ata nga Covid-19. Në këto kushte CLR iu drejtua Ministrisë përkatëse për adresimin e këtij problemi që përveç të tjerave nuk iu lejon punonjësve të sektorëve të prodhimit që të marrin me vete edhe mjete të tjera të domosdoshme (ujë në sasi të madhe, etj) në këtë kohë emergjence, të cilat nuk iu garantohen në vendin e tyre të punës (vende pune në qendrat e shpërndara në territor të nxjerrjes dhe prodhimit të naftës).

**Në mbyllje të tremujorit të parë 2020,** CLR ngriti një shqetësim të dyfishtë lidhur me të drejtat e punonjësve për përfitimin nga vendimet për pagesën për papunësinë. CLR publikoi me këtë rast qëndrimin për naftëtarët e Ballshit të cilët përveç se përkohësisht të papunë nga 1 janari 2020, nuk kanë mundur të përfitojnë as pagesën e papunësisë të dyfishuar sipas VKM Nr.254, datë 27.03.2020 për shkak se nuk kanë pasur mundësi objektive të aplikojnë në kohë peë pagesën e papunësisë. CLR kërkoi ndërhyrjen e menjëhershme të prefektit të qarkut Fier duke i kërkuar që të koordinonte punën me ministrinë e ngarkuar për zbatimin e planit ekonomik për shkak të Covid-19 dhe ministritë përkatëse, MFE dhe MIE, me qëllim që secilit nga punëtorët t'i krijohet mundësia e përfitimit të kësaj pagese përsa kohë vazhdon pezullimi i punës.

Në vijim të monitorimit të realiteteve të ndryshme të punës në terren, CLR, **në Prill 2020** denoncoi ndërprerjen e marrëdhënieve të punës në një kompani call center, të kryer në kundërshtim me ligjin dhe që CLR e konsideroi si keqinterpretim të nenit 129/3 të Kodit të Punës. Sipas kësaj dispozite ligjore, lejohet pezullimi i pagës në situatën e krijuar vetëm nëse punëdhënësi në mënyrë të argumentuar e ka objektivisht të pamundur të ngarkojë punëmarrësin me punë. Sipas CLR, këtë pamundësi punëdhënësi duhet ta diskutojë me sindikatën që përfaqëson punonjësit ose në mungesë të saj me një përfaqësi të zgjedhur të punonjësve me të cilën në përfundim të diskutimeve duhet të dakordësojnë një marrëveshje të posaçme dhe të detajuar për të gjithë hapat deri në përfundim të gjendjes së jashtëzakonshme të krijuar. Në asnjë mënyrë kjo pamundësi objektive për të ngarkuar me punë punëmarrësin nuk i jep të drejtën punëdhënësit të ndërpresë marrëdhënien e punës me punëmarrësin, qoftë edhe përkohësisht.

**Më 18 Prill 2020,** me daljen e paketës së dytë financiare të akorduar nga qeveria shqiptare, CLR informoi sindikatat dhe grupet e punëmarrësve të interesuar lidhur me kategoritë që përfitojnë prej saj.

Kategoritë që përfitojnë pagesën 40 000 Lekë sipas paketës së dytë të ndihmës financiare për të punësuarit dhe punonjësit e larguar nga puna si pasojë e Covid-19 do të ishin:

- *Të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore mbi 14 milion Lek, që kanë mbyllur aktivitetet sipas urdhrave të Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë në datën e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave.*
- *Ish të punësuarit në subjektet që janë lejuar të kryejnë aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët janë larguar nga puna nga data e hyrjes në fuqi të këtyre urdhrave deri në datën 10 prill 2020. Dita e dorëzimit të E-sig 027 nuk duhet të jetë më e vonë se data 10 prill 2020.*
- *Të punësuarit në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 milion Lekë, që janë lejuar të kryejnë aktivitetet sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, të cilët kanë qenë në punë deri në datën e hyrjes në fuqi të urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
- *Nuk e përfitojnë ndihmën sipas pikës 3, punonjësit të cilët kanë përfituar sipas pikës 2 të punësuar në subjektet: me objekt veprimtarie tregtim të produkteve ushqimore, fruta – perime, farmaceutike, që ushtrojnë aktivitet në profesione të tilla si: avokat, noter, mjek i specializuar, farmacist, infermier, veteriner, arkitekt, inxhinier, mjek-laborant, projektues, ekonomist, agronom, ekspert kontabël i regjistruar, kontabilist i miratuar dhe vlerësues i pasurisë, që lejohen të kryejnë aktivitetin sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
- *Punonjësit e subjekteve, persona fizikë ose juridikë, që ushtrojnë aktivitetin si struktura akomoduese, të cilët figurojnë në listëpagesa deri në datën e urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.*
- *Nëse subjekti i përmendur në pikën 5, ushtron disa lloje aktivitetesh, e përfitojnë ndihmën financiare vetëm të punësuarit në aktivitetin e strukturës akomoduese.*

**CLR në kontekstin e kësaj ndihme financiare, asistoi punonjësit e sektorit call center duke publikuar njoftimin nisur nga kërkesat për informacion nga shumë të punësuar në sektorët call center dhe fasoneri. Nga informacioni zyrtar i deriatëhershëm, të punësuarit e subjekteve joakomoduese që janë lejuar të kryejnë aktivitetin dhe janë të punësuar në kompani me të ardhura vjetore mbi 14 milionë lekë, këtu hyjnë përgjithësisht të punësuarit në call center, fasoneri etj, nuk e përfitonin pagesën 40.000 lekë. Për këta punëmarrës, punëdhënësi, në pamundësi për të shlyer pagat për shkak të Covid-19, duhet të marrë kredi nga banka me komisione të garantuara nga garancia sovraane e vënë në dispozicion nga shteti.**

**Më 20 Prill 2020, CLR reagoi publikisht dhe me forcë në lidhje me fasonërinë në Krujë në lidhje me rastet e infektiveve nga Covid-19 të një grupi punonjësish së kësaj kompanie. Alarmi që ngriti CLR vijon si më poshtë:**

*“Kjo fasoneri rezulton si vatra më e madhe aktive e përhapjes së infeksionit Covid 19 në zonën e Krujës dhe Kurbinit. Hetimi i situatës dhe historikut epidemiologjik është një detyrim i pashmangshëm në situatën në të cilën gjendemi por a është ky i vetmi hetim që duhet kryer në ndërmarrjet në të cilat është lejuar puna? Pyetjet e tjera të rëndësishme që CLR me vendosmëri ngre, janë si më poshtë:*

- *A ka patur një kontroll të vazhduar në këto njësi prodhimi nga ana e Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor dhe atij të Punës?*
- *A ka patur një këqyrje paraprake të qendrave të punës para rifillimit të punës me qëllim të rivlerësimit të standardeve të sigurisë, distancës së lejuar në varësi të sipërfaqes, rikimpozimit të vendeve të punës në rast se vlerësohet e nevojshme, shmangien dhe eliminimin e mjeteve ose pajisjeve/lëndëve të punës të cilat mund të shtonin në mënyrë eksponenciale rrezikun e infektimit?*
- *Sa të informuar janë punëdhënësit dhe punëmarrësit për mënyrën e re të të punuarit? A ekziston Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit në punë në këtë fabrikë? A është konsultuar*

**Phone**

+355 69 402 0057

**Address**

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

**Website**

www.clr.al

*ai në situatën e krijuar dhe a ka qenë pjesë e këshillimeve dhe vendimmarrjes për hartimin e rregulloreve të reja të punës?*

- *A ka sindikatë brenda kësaj fabrike? Nëse po, cila është ajo dhe çfarë masash ka marrë për t'i ardhur në ndihmë anëtarësisë së vet?*
- *Si mbahen nën presion nga ana e autoriteteve të linjës punëdhënësit dhe punëmarrësit për të mos rënë në zakonet e natyrshme dhe të ngulitura thellë të të punuarit të para Covid-19, pra për të mos ulur vigjilencën dhe përgjegjshmërinë ndaj ekzistencës së rrezikut?*
- *A nuk duhet të ketë një nismë të qeverisë për të ndihmuar bizneset prodhuese ose ato njësi pune me përqendrim të lartë punonjësish me masat mbrojtëse ndihmëse si doreza, maska, detergjentë, etj?*

*Sipas legjislacionit shqiptar të punës, garantimi i mjeteve mbrojtëse individuale dhe kolektive janë vërtet detyrim i punëdhënësit, por sa është barra me të cilën po përballet biznesi këtë kohë dhe a është ai në gjendje ta mbartë këtë barrë? Këto pyetje dhe të tjera dëshirojmë të vendosim para syve dhe veshëve të institucioneve përgjegjëse të cilët megjithë gatishmërinë e lartë dhe eficientë në përballimin e situatës së krijuar, nuk mund dhe nuk duhet të veprojnë më të vetëm dhe të pakonsultuar me grupet e interesit. Edhe sa kohë mendoni ju se do të vazhdojmë pa punuar? Jo edhe për shumë, është e qartë. Vëmendja, për këtë arsye duhet tashmë me vend të kthehet edhe ndaj politikave në vendin e punës, thënë më thjesht: Si do të vazhdojmë të punojmë pa dëmtuar jetën tonë dhe të atyre që na rrethojnë?”*

**Në fund të Prillit 2020**, në përshtatje të situatave që pasuan, nisur edhe nga fillimi i rihapjes së ekonomisë, CLR shpreh reagimin e saj në lidhje me rifillimin e çeljes graduale të punës, duke shpërndarë disa këshilla të rëndësishme të publikuara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë për masat mbrojtëse që duhet të merren në vendin e punës për kufizimin e përhapjes së Covid-19.

- *“Të punojmë, por të sigurtë!*
- *Sigurohuni që vendet e punës të jenë të pastra dhe higjienike!*
- *Sipërfaqet dhe objektet e punës duhet të dezinfektohen me higjienizues vazhdimisht sepse infektimi ndodh nëpërmjet prekjës së objekteve të kontaminuara.*
- *Vendosni higjienizues duarsh në vende të dukshme të punës dhe sigurohuni që të jenë gjithmonë të mbushura!*
- *Sigurohuni që stafi i brendshëm, bashkëpunëtorët dhe klientët të kenë akses në ambientet e higjienës!*
- *Bëni aktiv Këshillin e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë dhe në mungesë këshilloni vazhdimisht stafin për rëndësinë e higjienës!*
- *Shpërndani postera që promovojnë rëndësinë e higjienës së mirë respiratore!*
- *Punëdhënësi duhet të sigurojë maskat e fytyrës dhe shamitë e letrës në mënyrë të vazhdueshme për punëmarrësit e vet!”*

**Në prill 2020**, CLR përsërit reagimin publik në lidhje me naftëtarët e rafinerisë së Ballshit të cilët nuk kishin përfituar ende deri në këtë periudhë as pagën e luftës, as pagesën e papunësisë të dyfishuar, as pagesën prej 40.000 lekë nga mbështetja e zgjeruar financiare e qeverisë. Si rezultat i solidaritetit dhe advokimit të shumë aktorëve të fushës së punës, në **fund të Prillit** naftëtarët e KPTHN -Ballsh arritën të përfitojnë shpërbllimin 40 000 lekë të reja sipas një vendimi të posaçëm të Këshillit të Ministrave vetëm për këta punonjës. Ky rast tregon edhe njëherë fuqinë që kanë punëtorët kur bëhen bashkë për kauza të caktuara që prekin të drejtat e tyre në punë

**Në fund të Prillit 2020, CLR në bashëpunim me sindikata dhe organizata të tjera partnere të shoqërisë civile inicioi një peticion me propozime dhe masa konkrete për qeverinë, në mbështetje të punonjësve shqiptare.**

Në vijim mund të gjeni deklaratën e plotë:

**DEKLARATË E PËRBASHKËT  
E SINDIKATAVE DHE SHOQËRISË CIVILE SHQIPTARE NDAJ EMERGJENCËS SË  
COVID-19**

*Në emër të një grupi sindikatash dhe organizatash të shoqërisë civile të angazhuara në mbrojtjen e të drejtave në punë, të drejtave të njeriut dhe të taksapaguesve në Shqipëri, duke shprehur me dhimbje edhe ngushëllimet për të gjithë që kanë humbur tashmë të dashurit nga COVID-19, duam të shprehim mirënjohjen dhe mbështetjen tonë ndaj:*

- punonjësve të sektorit shëndetësor,
- punonjësve të policisë së shtetit, policisë së burgjeve, shërbimit zjarrëfikës dhe shërbimeve të tjera policore,
- punonjësve të prodhimit të bukës;
- punonjësve publikë dhe privatë që mbajnë në gatishmëri funksionet bazë të vazhdimësisë së jetës së vendit në sektorët strategjikë dhe shërbime të përditshme.

*Ne jemi duke ndjekur nga afër zhvillimet e epidemisë COVID-19 në të gjithë vendin dhe shprehim gatishmërinë për të kontribuar me ekspertizën tonë në hartimin dhe zbatimin e masave të jashtëzakonshme për t'iu ardhur në ndihmë ndërmarrjeve dhe punëtorëve në përballjen me këtë emergjencë.*

*Sindikatat dhe shoqëria civile e angazhuar në botën e punës dhe të drejtat e njeriut mbështesin vetëm atë grup masash të cilat bazohen në ligjet në fuqi dhe në kushtetutën e Shqipërisë të cilat janë njoftuar nga Qeveria shqiptare dhe Banka e Shqipërisë dhe nuk çenojnë të drejtat e njeriut dhe janë në kontakt të ngushtë me gjithë palët e përfshira në këtë luftë për të ndihmuar në sigurimin e një zbatimi të shpejtë dhe efektiv të tyre.*

*Megjithatë, konstatojmë se të dyja paketat e deritanishme të masave kanë nevojë të plotësohen më tepër për të ndihmuar nevojat minimale për punëmarrësit, sidomos ata në sektorin privat, si grupi më problematik dhe vulnerabël i marrëdhënive të punës në situatën ku ndodhemi.*

*Propozojmë që Qeveria, ndërmarrjet publike dhe ato private të marrin masa që parashikojnë:*

1. Inkurajimin e shpenzimeve dhe investimeve, veçanërisht për të mbrojtur burimet njerëzore, pajisjet dhe mjetet për shërbimet shëndetësore, sistemet e mbrojtjes sociale dhe shërbimet e tjera me interes të përgjithshëm;

2. Mobilizimin e fondeve strukturore të papërdorura dhe çdo fond tjetër të disponueshëm për sigurimin e mbështetjes financiare dhe të ardhurave për punonjësit e prekur nga papunësia ose pezullimi nga puna, përfshirë punonjësit me kontrata në provë dhe të vetëpunësuarit;

3. Aktivizimin e plotë të fondit të solidaritetit për katastrofat natyrore dhe çdo fond tjetër të disponueshëm në nivelin kombëtar dhe vendor;

4. Punëdhënësit, aktiviteti i të cilëve është prekur për shkak të pandemisë, në bashkërendim me përfaqësuesit e punëmarrësve të diskutojnë dhe vendosin së bashku për mundësinë e uljes së pagave deri në nivelin e pagës minimale me qëllim ruajtjen e vendeve të punës dhe vazhdimësinë e punës;

5. Punëdhënësit në bashkërendim me përfaqësuesit e punëmarrësve dhe/ose Këshillat e Sigurisë dhe Shëndetit në Punë të diskutojnë dhe vendosin bashkërisht për mënyrën e organizimit të punës dhe respektimin e kushteve për mbrojtjen nga Covid 19;

6. Vetëm për vitin 2020 të vendoset që deri 50% e pushimit vjetor të kompensohet me periudhën e pushimit për shkak të Covid -19;

7. Punëdhënësit në sektorin privat të garantojnë pagesën e punonjësve për muajin mars 2020 pasi një pjesë e tyre në sektorët me numër të madh të punësuarish si në fasoneri dhe call center nuk e kanë bërë, duke e ndërprerë pagesën në momentin që kanë pezulluar punën;

8. Punëdhënësit dhe qeveria, në çdo nivel, të konsultohen paraprakisht dhe të arrijnë marrëveshje me sindikatat përfaqësuese të punëmarrësve për masat që duhen ndërmarrë për shkak të Covid 19. Marrëveshjet e tilla, bazuar në një dialog efektiv punëdhënës-punëmarrës, kanë potencialin për të adresuar më mirë problemet reale me të cilat përballen punëtorët dhe kompanitë;

9. Sindikatat e sektorëve që përfaqësojnë punonjësit e sektorëve shëndetësorë, të shërbimeve policore dhe të tjerë sektorë punonjësit e të cilëve janë në vijën e parë të përballjes me covid 19 të jenë më shumë se aktivë për të mbrojtur të drejtat e punonjësve që ata përfaqësojnë;

*Qeveria shqiptare dhe institucionet publike:*

1. Të ndërmarrin të gjitha masat për pajisjen me mjete mbrojtëse të punonjësve të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve policore që janë në vijën e parë të përballjes me Covid- 19.

2. Të shihet mundësia që përveç punonjësve të sistemit shëndetësor në vijën e parë të përballjes me pandeminë, në mënyrë proporcionale me angazhimin e tyre të ketë edhe shpërblime mirënjohjeje për punonjësit e tjerë në shërbimin shëndetësor dhe në shërbimet e tjera të angazhuara në përballjen e pandemisë.

3. Të vijohet me të paktën garantimin e pagës minimale për dy deri në tre muajt në vazhdim për punonjësit në kompani të mëdha të sektorit publik dhe për punonjësit që aktualisht nuk mund të punojnë për shkak të Covid-19;

4. Të mundësohet transferimi i një shume fikse mjetesh monetare direkt për secilin qytetar që është në moshë pune dhe nuk ka mundësi të punësohet (të papunët);

5. Të evidentohen të gjithë të punësuarit me sëmundje kronike apo auto imune dhe t'u garantohet atyre masa mbrojtje shtesë të posaçme dhe në pamundësi t'u jepet pushim i përkohshëm deri në përmirësimin e situatës;

6. Pezullimi i pagesave të dividendit duhet të jetë një kusht i qartë i lidhur me mbështetjen për tatimpaguesit, siç mund të jenë kërkesat për të prekur ato fonde të kompanive të mëdha, të cilat janë për qëllime të tjera përdorimi. Nëse shpërndarja e dividendëve vazhdon, qeveria duhet të

*rrisë taksimin mbi këto dividente të pajustificueshëm për të financuar shërbimet publike që shtrihen deri në pikën e fundit të kësaj krize;*

*7. Shoqëritë private dhe ajo publike e furnizimit me energji elektrike të përjashtojnë pjesën fikse të faturave të energjisë elektrike për bizneset që kanë ndaluar funksionimin e aktivitetit për shkaqe të lidhura me pandeminë;*

*8. Qeveria dhe Institucionet duhet të përfshijnë Partnerët Socialë në hartimin dhe zbatimin e masave në çdo nivel. Në shumë vende, sindikatat kanë negociuar me punëdhënësit dhe qeveritë për të vendosur mbi politika të cilat do të sigurojnë të ardhurat afatshkurtra dhe jetesën afatgjatë të punëtorëve.*

*9. Qeveria dhe institucionet duhet të bëjnë transparencë të plotë, të vazhdueshme dhe periodike për mënyrën e shpenzimit të fondeve të vëna në dispozicion, shkallën e zbatimit të masave të ndërmarrja dhe numrit të punonjësve dhe qytetarëve që kanë përfituar nga mbështetja e ofruar;*

*10. Komisioni qeveritar dhe task forca ndër-institucionale të ngritur për këtë qëllim duhet të sigurohet që mbështetja financiare arrin të ndërmarrjet, veçanërisht të të gjitha kategoritë e bizneseve të vogla, si dhe të të gjithë punëtorët, përfshirë të vetëpunësuarit dhe ata me punë të përkohshme dhe që janë ndër më të rrezikuarit;*

*Ndërkohë do të ishte me vlerë, që ashtu si po veprohet në Kroaci të mendohet për të hartuar një Akt për rregullimin e marrëdhënieve të punës në rrethanat e epidemisë COVID-19 dhe me të cilat të përcillen disa ndryshime të rëndësishme në të drejtat themelore sociale pasi ato aktualisht nuk janë të parashikuara në Kodin e Punës për aq sa ndikohen nga situata e re e krijuar nga Covid -19.*

*Në përfundim, ne besojmë se parimi i humanizmit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, direktivat e Bashkimit Evropian ku dëshirojmë të integrohemi, duhet të mbizotërojnë në çdo nismë të ndërmarrë nga qeveria shqiptare, punëdhënësit dhe punëmarrësit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore ku ndodhemi dhe që kërkon angazhimin dhe sakrificën e secilit prej nesh.*

*Të gjitha përpyekjet duhet të ndërmerren për të ndihmuar punëtorët, ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike dhe shërbimet publike për të mbijetuar nga kriza, kështu që ata do të jenë në gjendje të kthehen në aktivitetet e tyre kur të përfundojë kriza, të ruajnë vendet e punës dhe të mbrojnë punëtorët nga papunësia dhe humbja e të ardhurave.*

*Organizatat nënshkruese:*

- 1. Centre for Labour Rights CLR.AL*
- 2. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë BSPSH*
- 3. Gender Alliance for Development Center GADC*
- 4. Sindikata e Shërbimeve Policore të Shqipërisë*
- 5. Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptar SRNSH*
- 7. Sindikata e Punonjësve të Sistemit Shëndetësor SPSHSH*
- 8. Sindikata e Pavarur e Ushqimit, Agroturizmit, Tregtisë dhe Turizmit*
- 9. Sindikata e Punonjësve të Shërbimeve Publike SPSHP*
- 10. Sindikata e Punonjësve të Qendrave të Kontaktit*



11. Qendra për Zhvillim, Bashkëpunim dhe Integrim CDCI

12. Qendra Rinore Vlorë.

### **Kjo nismë e CLR për petitionin pati jehonë edhe në median e shkruar.**

CLR në mbështetje dhe përhapje të frymës së bashkëpunimit është solidarizuar duke publikuar artikullin e shkruar në lidhje me sindikatat kërkojnë mbrojtje të punëtorëve të fasonerive të Reporter.al. Një numër sindikatash dhe organizatash të shoqërisë civile bënë thirrje për një komunikim më të gjerë mes punëdhënësve, punëmarrësve dhe qeverisë për të trajtuar problemet ekonomike të shkaktuara nga pandemia e koronavirusit të ri, si dhe për të gjetur me mirëkuptim zgjidhjet e mundshme. Sindikatat sugjeruan që punëdhënësit dhe punëmarrësit të arrijnë një kompromis për pagesë të pagave të pjesshme gjatë periudhës së bllokimit të punës si dhe nxitën qeverinë të mbulonte një pjesë të kostove të biznesit për të mundësuar vijimin e jetës sa më normalisht të jetë e mundur. Sindikatat sugjeruan gjithashtu që punëdhënësit dhe punëmarrësit të arrijnë një kompromis për të kompensuar një pjesë të humbjeve të shkaktuara nga pandemia përmes zëvendësimit të ditëve të humbura me një pjesë të ditëve pushim gjatë muajve pas kapërcimit të pandemisë.

*“Punëdhënësit dhe qeveria, në çdo nivel, të konsultohen paraprakisht dhe të arrijnë marrëveshje me sindikatat përfaqësuese të punëmarrësve për masat që duhen ndërmarrë për shkak të Covid 19. Marrëveshjet e tilla, bazuar në një dialog efektiv punëdhënës-punëmarrës, kanë potencialin për të adresuar më mirë problemet reale me të cilat përballen punëtorët dhe kompanitë,”* thuhet në deklaratën e përbashkët të publikuar në Facebook. *“...Ne besojmë se parimi i humanizmit dhe respektimit të dinjitetit njerëzor të sanksionuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, direktivat e Bashkimit Evropian ku dëshirojmë të integrohemi, duhet të mbizotërojnë në çdo nismë të ndërmarrë nga qeveria shqiptare, punëdhënësit dhe punëmarrësit në kushtet e gjendjes së fatkeqësisë natyrore ku ndodhemi dhe që kërkon angazhimin dhe sakrificën e secilit prej nesh”,* shkruhet në deklaratë. *“Të gjitha përpjekjet duhet të ndërmerren për të ndihmuar punëtorët, ndërmarrjet, aktivitetet ekonomike dhe shërbimet publike për të mbijetuar nga kriza, kështu që ata do të jenë në gjendje të kthehen në aktivitetet e tyre kur të përfundojë kriza, të ruajnë vendet e punës dhe të mbrojnë punëtorët nga papunësia dhe humbja e të ardhurave,”* vijon më tej deklarata.

Deri në prill 2020, qeveria shqiptare ndërmori dy paketa ndihme që kanë shënjestruar biznesin e vogël dhe të papunët e krijuar nga pandemia përmes pagesave të drejtpërdrejta nga buxheti ndërsa për biznesin e madh është sugjeruar mbështetje me kredi për të shlyer pagat e punonjësve, gjë që u duk se nuk u materializua në shkallën e nevojitur.

Shqipëria pritet të humbasë rreth 5% të prodhimit të vet bruto të vitit 2020 si pasojë e paralizimit ekonomik të shkaktuar nga pandemia, por ekonomia pritet të rimëkëmbet me një rritje në masën 8% vitin e ardhshëm dhe 6% në vitin 2022. Megjithatë, rreziku është i lartë që një pjesë e bizneseve të mos arrijnë të mbijetojnë gjatë pandemisë, gjë që mund të pengojë rimëkëmbjen ekonomike në periudhën pas saj.

Në vazhdim të muajve të pandemisë dhe në mbrojtje të grupit të punonjësve më të sprovuar prej saj, pra punonjësit e sistemit shëndetësor, Sindikata e Punonjësve të Shërbimit Shëndetësor, SPSHSH, kërkoi që të gjithë ata mjekë dhe infermierë të cilët kanë ndërruar jetë si pasojë e Covid-19, të shpallen dëshmorë të kombit. Me anë të një deklaratë, Sindikata parashtrroi para Kryeministrit dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, 4 kërkesa themelore:

**Phone**

+355 69 402 0057

**Address**

Rr."Frederik Shiroka" Pallati "Alba", Shk. 4, Ap. 7

**Website**

www.clr.al

- *Të shpallen dëshmorë të kombit të gjithë ata pjesëtarë të personelit shëndetësor, të cilët humbin jetën në luftë me Covid-19.*
- *Të bëhet sigurimi i jetës të personelit shëndetësor me qëllim që familjet e tyre të mund të vazhdojnë jetën denjësisht edhe pas fatkeqësive të mundshme në këtë luftë.*
- *Rritje e vlerësueshme e trajtimit financiar të personelit shëndetësor.*
- *Personelit shëndetësor të çdo niveli t'i sigurohen të gjitha kushtet optimale në punë për parandalimin e infeksionit sipas të gjitha standardeve kombëtare dhe ndërkombëtare.*

Më **5 nëntor 2020**, Qëndresa Qytetare, CLR në bashkëpunim të ngushtë me Olof Palme International Center, zhvilloi tryezën e diskutimit me temë **“E Drejta e Protestës në Kohë Pandemie”**. Kjo tryezë solli shqetësimin e dy organizatave për kufizimin absolut të së drejtës civile për të protestuar në kohë pandemie, ishte shqetësimi që iu adresua kryetares së Komitetit të Eksperteve dhe Zv. Ministres së Shëndetësisë, znj. Mira Rakacolli, e pranishme në takim. Gjatë takimit, Qëndresa Qytetare, CLR dhe të tjerë aktivistë të shoqërisë civile sollën raste konkrete të veprimeve të Policisë së Shtetit që iu ka mohuar të drejtën e protestës qindra qytetarëve si dhe ka shpërndarë forcërisht me dhjetëra protesta të organizuara në të gjithë vendin. Tryeza u përshëndet edhe nga ambasadorja e Suedisë në Shqipëri, znj. Elsa Hastad, e cila i vlerësoi si shumë të rëndësishme protestat në një shoqëri demokratike, edhe në situatë pandemie. E jashtëzakonshme është puna dhe kontributi i Avokatit të Popullit, znj. Erinda Ballanca, institucioni i së cilës adresoi me seriozitet këtë situatë të krijuar në vend, duke kontribuar me analizën dhe rekomandimet drejtuar institucioneve shqiptare, për të mos ndaluar të drejtën e qytetarëve të protestojnë. Qëndresa Qytetare, CLR dhe Olof Palme International Center së bashku me aktorët kryesorë të tryezës, u zotuan të ndjekin në vazhdimësi këtë të drejtë kaq të rëndësishme të qytetarëve të vendit tonë deri në ushtrimin e saj në mënyrë të lirë.

Në vazhdim të kësaj nisme, më **19 nëntor**, CLR publikoi letrën e hapur **“E drejta e Protestës në kohë pandemie”**, të nënshkruar nga 35 organizata dhe sindikata dhe që iu drejtua gjithashtu institucioneve qeveritare për lejitimin e të drejtës së qytetarëve për të protestuar. Në këtë letër midis të tjerash shkruhej se mungesa e protestës vret demokracinë e për pasojë jetën e qytetarëve të cilët nëse qeverisen nuk mund t’ju ndalohet protesta ndaj mënyrës së qeverisjes, nëse u lejohet të punojnë, nuk mund t’ju ndalohet të protestojnë për shkeljet që iu bëhen në punë, nëse mjekët lejohet të punojnë nuk mund t’ju ndalohet të ankohen për kushtet “vrasëse” të punës së tyre në spitale. Prandaj protestat nuk duhen ndaluar, ashtu si në të gjitha vendet e zhvilluara të cilat megjithëqë kanë një situatë më të rënduar të pandemisë, nuk e kanë mohuar të drejtën e protestës, por kanë vendosur protokolle të posaçme për protestat për të parandaluar përhapjen e infeksionit Covid 19.

35 organizatat e shoqërisë civile dhe sindikatat e pavarura iu drejtuan institucioneve më të larta të vendit për të kërkuar:

- *Një protokoll anti- covid për organizimin e protestave qytetare ashtu si protokollet për baret, kafet, kinematë e pishinat*
- *Rishikimin e masave ligjore në lidhje me të drejtën e tubimit*
- *Ndërprerjen e menjëhershme të praktikës së deritanishme të Policisë së Shtetit për moslejimin e tubimeve në ambiente të hapura nga ana e qytetarëve*

Prej gjithë kalvarit të përshkruar nga CLR dhe organizatat partnere për të asistuar, informuar, mbështetur, denoncuar dhe garantuar me propozime direkte për përbalimin e situatës

pandemike në botën e punës, mund të thuhet se tashmë është fituar një përvojë e madhe për të dalë me dëme sa më të pakta nga ngjarje të tilla të pandodhura. CLR ka qenë dhe mbetet me çdo mënyrë mbështetëse aktive për realizimin e të drejtave në punë duke mbështetur çdo përpjekje të punonjësve dhe përfaqësuesve të tyre për më shumë të drejta dhe duke kërkuar nga qeveria shqiptare dhe punëdhënësit që me riaktivizimin e punës të mos anashkalohet asnjë e drejtë kolektive e punonjësve. Punonjësit në këtë moment duhet të jenë të bashkuar, të vëmendshëm dhe sa më aktive me të gjitha format e reagimit dhe sidomos me tubimet dhe protestat të cilat ata sot i bëjnë më mirë se cilido tjetër në Shqipëri dhe janë shembull për të gjithë. Vetëm në këtë mënyrë, ata nuk do përjashtohen nga e drejta për të mbrojtur dhe përfaqësuar edhe kolektivisht të drejtat e tyre në vendin e punës. Një sprovë e tillë shërbeu për të kuptuar që pikërisht përballja me situata të tilla katastrofike i bëjnë bashkë dhe u japin më shumë forcë punonjësve për të qenë më të bashkuar ndaj të drejtave në punë, rritjes së sigurisë dhe organizimit kolektiv të tyre.

## **Kuti 1**

### **Peë herë të parë në Shqipëri !!**

*Histori frymëzuese suksesi të sindikatave të reja*

**Sindikata e Re e Naftëtarëve Shqiptarë, SRNSH<sup>14</sup>** dërgon çështjen e diskriminimit në pagë të një grupi punonjësish të kompanisë Albpetrol, pranë Komisionerit Shtetëror për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe fiton kundër punëdhënësit, kompanisë më të madhe të naftës në vend. Komisioneri Për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>15</sup> konstaton diskriminim në pagë për punonjësit e administratës dhe ka vendosur të detyrohet punëdhënësi të korigjojë praktikën diskriminuese për punonjësit dhe çdo punonjësi t'i paguhet diferenca e pagës së papaguar për të gjithë muajt kur kjo ka ndodhur.

Gjithashtu, me asistencën e CLR dhe pas dialogut intensiv me punëdhënësin gjatë muajve të parë të pandemisë, në prill- maj 2020 u arrit që 90% të punonjësve të Albpetrol të mos iu preken pagat. Punonjësit vazhduan të paguheshin me pagat ashtu siç ato janë përlllogaritur me rritjen e fundit të negociuar nga sindikata (rasti i vetëm këto 10 vitet e fundit). Për 10% të punonjësve ku përfshihet administrata e lartë, negociatat nuk rezultuan të suksesshme, megjithëse ende vazhdojnë.

Bazar në vendimarrjen e strukturave të sindikatës, paralelisht me diskutimet dhe negociatat që po SRNSH zhvilloi me përfaqësues të kompanisë, u ndoqën edhe këto hapa:

1. Paraqitja e këndvështrimit të sindikatës për zgjidhje dhe përfshirje në dialogun për zgjidhjen e problematikave edhe të Ministrisë së linjës
2. Peticion Kryeministrit me kërkesat e tyre të firmosur nga të gjithë nafëtarët që janë mbledhur
3. Vënie në lëvizje të Zyrës Kombëtare të Ndërmjetësimit dhe Pajtimimit për ta trajtuar dhe adresuar rastin si konflikt kolektiv
5. Gjithashtu, sindikata konsideroi edhe mundësinë për ndjekjen ligjore të rastit.

<sup>14</sup> <https://ëëë.kmd.al/ëp-content/uploads/2020/10/Vendim-nr.-107-dat%C3%AB-11.09.2020-Sindikata-e-Re-e-Naft%C3%ABtar%C3%ABve-Shqiptar-kund%C3%ABR-Shoq%C3%ABris%C3%AB-Albpetrol-sh.a-Diskriminim.pdf>

<sup>15</sup> <https://ëëë.kmd.al/ëp-content/uploads/2020/11/Vendim-Nr.-168-dat%C3%AB-17.11.2020-I.Xh-dhe-J.K-kund%C3%ABR-Shoq%C3%ABris%C3%AB-BCONNECT-SH.P.K-Diskriminim.pdf>

**Sindikata Kombëtare e Operatoreve Telefonike (SKOT)** - një sindikatë e re krijuar në vitin 2020 nga vetë punonjësit e call center, pa zhurmë mediatike, por me shpirt rebelizmi dhe aktivizmi për të luftuar të gjitha padrejtësitë që ndodhin në vendin e punës. Falë përpjekjeve kolektive të grupit të punonjësve të bashkuar në SKOT, u arrit që të fitohet pagesa e papaguar për festat zyrtare të vitit 2019, në vlerën e 350 mijë lekëve të vjetra për çdo njërin nga 380 punonjësit e kompanisë B-Connect, për një total prej më shumë se 130 milionë lekësh. Në rastin më sipër, themeluesit e SKOT<sup>16</sup>, përpara se të krijonin sindikatën i janë drejtuar komisionerit kundër diskriminimit për largimin e padrejtë nga puna. Për shkak se akoma nuk ishin formalizuar si sindikatë, Komisioneri ka konstatuar diskriminim në largimin e tyre nga puna.

Me iniciativën e Sindikatës "**Solidariteti**", Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale i ka dhënë zgjidhje në favor të punonjësve një konflikti kolektiv ndërmjet sindikatës së punonjësve dhe kompanisë call center "Teleperformance".

Sipas Komisionerit, monitorimi apo survejimi me kamera i punonjësve, jo vetëm në ambjentet e shtëpis, por edhe në ato të punës, për efekt të monitorimit të performancës së tyre në punë është i kundërligjshëm.

Kjo zgjidhje i shërben jo vetëm punonjësve në rastin konkret, por edhe shumë punonjësve të tjerë në çdo sektor të ekonomisë, puna e të cilëve është bërë shpesh objekt i monitorimit me kamera.

Një tjetër arritje e rëndësishme sindikaliste, është detyrimi i qeverisë shqiptare nga ana e Sindikatës së Naftëtarëve të Ballshit për zgjidhjen e konfliktit kolektiv të shkaktuar nga mospagesa e pagave të punonjësve të ish-rafinerisë Ballsh.

<sup>16</sup> [https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/12/Rekomandim\\_nr\\_27\\_AMSSHT.pdf](https://www.idp.al/wp-content/uploads/2020/12/Rekomandim_nr_27_AMSSHT.pdf)